

1 E enjte, 7 shtator 2023

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

4 [I akuzuari Krasniqi paraqitet përmes]

5 videolidhjes]

6 --- Seanca fillon në orën 09.08

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mund të
8 vazhdoni, z. Emmerson.

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] Përpara sesa të fillojmë, ju
10 kërkoj ndjesë të gjithë anëtarëve të Trupit Gjykses dhe të
11 gjithë palëve në këtë proces gjyqësor për vonesën sot paradite
12 për të cilën jam tërësisht përgjegjës unë.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
14 pa problem, na ndodh të gjithëve, do mbijetojmë.

15 Znj. Sekretare, ju lutem paraqisni lëndën.

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar
17 Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i
18 Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep
19 Selimit dhe Jakup Krasniqit.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për
21 procesverbal, të gjithë të akuzuarit janë të pranishëm në
22 sallën e gjyqit përveç z. Krasniqi, që na ndjek përmes
23 videolidhjes.

24 Përpara sesa të fusim dëshmitarin në sallë, më lejoni
25 t'ju kujtoj se siç e kemi komunikuar dhe më herët, ne nuk do

1 të kemi një seancë të tretë sot. Kështu që do ta përfundojmë
2 seancën në orën 13.00 të drekës.

3 ZPS-ja, a mund të na thotë se cilët janë dëshmitarët që
4 planifikon të thërrasë në sallën e gjyqit javës që vjen?

5 Z. TIEGER: [Përkthim] Po, të nderuar Gjykatës.

6 Dëshmitarët janë konfirmuar në një mesazh elektronik që është
7 dërguar dje rreth orës 17.41, megjithatë numrat e këtyre
8 dëshmitarëve për procesverbal do të jenë 03827, 04255 dhe
9 03724.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund ta
11 përsërisësh edhe njëherë?

12 Z. TIEGER: [Përkthim] 3724.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
14 Do të vazhdojmë me kundërpyetjet e dëshmitarit.

15 Z. Emmerson, kemi një kërkesë ne të Trupit Gjykses. Kur
16 të lexoni nga një dokument të cilin nuk mund ta paraqisni dot
17 në ekran, ju lutem, na jepni paragrafin dhe numrin e faqes të
18 asaj se çfarë lexoni në mënyrë të tillë që të mund ta mbajmë
19 shënim siç është për procesverbal.

20 Ju lutem kujtohuni që ta bëni këtë gjë.

21 Dhe së dyti, sa më shpesh të jetë e mundur, do ju
22 kërkonim që dokumentet t'i paraqisni në ekran se do jetë shumë
23 më e thjeshtë për neve të gjithë që t'i lexojmë bashkë me
24 juve, kështu që mund ta kemi më të qartë se për çfarë flisni.

25 Sekretare, ju lutem silleni dëshmitarin në sallë.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04408 (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson (Vazhdim)

Faqe 3

1 [Dëshmitari vijon dëshminë]

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes,
3 Dëshmitar.

4 DËSHMITARI: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sot do të
6 vazhdojmë me kundërpjetjet tuaja nga Mbrojtja. Ju kujtoj që
7 t'i përgjigjeni pyetjeve shkurtimisht me fjali të qartë. Nëse
8 nuk e kuptoni pyetjen kërkoni Avokatit t'jua përsërisë edhe
9 njëherë pyetjen ose t'jua sqarojë atë më tej.

10 Po ashtu mbani mend se duhet të shpjegoni se cila është
11 baza e njohurive, fakteve dhe rrethanave të lidhura me
12 përgjigjet ndaj pyetjeve të Avokatit.

13 Ju kujtoj se jeni nën detyrim të thoni të vërtetën siç u
14 deklarua prej jush në deklaratën solemne.

15 Po ashtu, mos harroni të flisni para mikrofonit dhe të
16 bëni një pauzë prej pesë sekondash përpara se të jepni
17 përgjigje, flisni në një ritëm të ngadaltë në mënyrë të tillë
18 që t'ju kapin përkthyesit.

19 Nëse e keni të nevojshme që të bëni pushim, lirisht mund
20 të na thoni dhe ne do të bëjmë organizimet e nevojshme.

21 Tani, do të vazhdojmë me kundërpjetjet e Mbrojtjes së z.
22 Veseli. z. Emmerson do të vazhdojë me pyetjet e mbetura.

23 Z. Emmerson, fjala për ju.

24 DËSHMITARI: W04408 [Vijon]

25 Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson:

1 [Vazhdim]

2 [Dëshmitari përgjigjet përmes përkthimit]

3 Z. EMMERSON: [Përkthim

4 PY. Z. Abrahams, duke marrë parasysh përgjigjet që dhatë dje
5 dhe mbrëmë natën dhe duke marrë parasysh edhe mënyrën sesi
6 jeni qasur besueshmërisë së burimeve ndërkohë që thjesht keni
7 marrë informacion nga raportet e mëparshme të Qendrës
8 Humanitare dhe të Së Drejtës, ne kemi parë edhe disa hollësi
9 të tjera, pra, janë burimet të cilat janë përdorur nga Qendra
10 Humanitare e së Drejtës ose The Humanitarian Law Centre [Në
11 anglisht]. A do ju befasonte të dini se në disa raste kur ju
12 keni përshkruar një ngjarje ose kur keni thënë që ka ndodhur
13 një ngjarje e caktuar kur keni cituar raportet e The
14 Humanitarian Law Centre si burim i informacionit tuaj, burimi
15 që është cituar nga The Humanitarian Law Centre për të njëjtin
16 rast është media serbe? A ju befason kjo?

17 PË. Do më duhet që të shikoj për çfarë e keni fjalën.

18 PY. Do t'jua tregoj, megjithatë duhet t'i përgjigjeni pyetjes
19 time së pari: A do ju befasonte fakti që unë po ju them që ju
20 keni cituar The Humanitarian Law Centre ndërkohë që vetë The
21 Humanitarian Law Centre ka cituar burimet serbe? Kjo është
22 pyetja për ju.

23 PË. Nuk i përgjigjem dot kësaj pyetjeje në qoftë se nuk më
24 tregoni se për çfarë e keni fjalën konkretisht, në qoftë se
25 nuk më jepni një shembull.

1 Z. EMMERSON: [Përkthim] Këtë dokumentin për të cilin e
2 kisha fjalën e kemi shtuar në listën e dokumenteve tona,
3 kërkojmë lejen e Gjykatës që ta paraqesim këtë dokument. Ne
4 kemi paraprirë këtë lloj përgjigje për këtë arsye e kemi
5 shtuar në listën e dokumenteve tona.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka
7 kundërshtime?

8 Z. TIEGER: [Përkthim] Jo, nuk kemi.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.
10 Sekretare, ju lutem mund ta paraqisni në ekran.

11 Z. EMMERSON: [Përkthim] Dokumenti për të cilin e kam
12 fjalën është dokumenti SITF00413220, pra, dokument që
13 përfundon me 220.

14 PY. Ju mund ta shikoni është një dokument që është burimi që
15 ju keni cituar në raportin tuaj është Qendra e Së Drejtës
16 Humanitare apo The Humanitarian Law Centre dhe siç mund ta
17 shikoni fillon me "Kosovë - Zhdukjet në Kohë të Konfliktit të
18 Armatosur".

19 PË. Po.

20 PY. Pra, dua që ta bëj edhe një herë pyetjen dhe të shikojmë
21 dhe disa referenca të tjera. Le të shohim konkretisht faqen
22 3220, 3224, ju kërkoj ndjesë dhe është dokumenti 3230. Në
23 qoftë se do shikojmë paragrafin 2.14 poshtë gjysmës së faqes.

24 Z. EMMERSON: [Përkthim] Në qoftë se është e mundur do i
25 kërkoja Sekretares që ta zmadhonte.

1 PY. Kemi një referencë për kidnapimin, rrëmbimin e Branko
2 Staletic në Mleçan dhe jepet një përshkrim i ngjarjeve që kanë
3 ndodhur. Dhe mund ta shikoni qartë besoj që burimi nga ku
4 është marrë informacioni dhe që është cituar aty është media e
5 Beogradit, është e saktë kjo?

6 PË. Po, e saktë.

7 Z. EMMERSON: [Përkthim] A mund t'i kërkoj Sekretares që
8 të paraqesë raportin tuaj ku e trajtoni këtë çështje. Është
9 dokument i cili ka marrë numrin e provës materiale P380 -
10 faleminderit që ma sqaruat - konkretisht dua që të paraqitet
11 faqja e shënuar me numrin 0364871.

12 PY. Ky është raporti që e keni shkruar ju. Është raporti i
13 bërë një muaj më pas. E shikoni raportin këtu?

14 Këto janë faktet dhe janë ekzaktësisht të njëjtat, si ato
15 që pamë më herët. Pra, Branko Staletic, Ratko Stalitic. Dhe
16 mund të shikoni në tekst edhe vetë mund ta lexoni, ku thuhet
17 që sipas The Humanitarian Law Centre ka ndodhur kjo ngjarja
18 këtu. Dhe në qoftë se do të shikojmë fundin e faqes
19 poshtëshënimin është e qartë që burimi është The Humanitarian
20 Law Centre. A e shikoni këtë, Dëshmitar?

21 PË. Po.

22 PY. Në qoftë se dëshironi mund t'ju jap edhe shembuj të tjerë
23 megjithatë mendoj që janë të mjaftueshëm këta shembuj që sapo
24 dhashë për të thënë, për të bërë këtë pyetje.

25 Kur e keni marrë, e keni trajtuar këto çështje në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04408 (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson (Vazhdim)

Faqe 7

1 raportet e mëpasshme dhe e kam fjalën këtu për raportin e
2 botuar në tetor të 1998. Ndërkohë që raporti i The
3 Humanitarian Law Centre ishte botuar më 5 gusht. Pra, raporti
4 i parë i Qendrës për të Drejtën Humanitare është botuar më
5 datë 5 gusht, ndërkohë që ju e keni botuar raportin tuaj në
6 tetor të 1998.

7 Dhe pas kohë më pas, pra, në dhjetor ju keni botuar një
8 tjetër raport "Ndalime dhe abuzime në Kosovë", në të cilin ju
9 jepni informacionin e njëjtë, domethënë, thjesht keni bërë një
10 përsëritje të informacionit që keni dhënë në raporte të
11 mëhershme vetëm thjesht e keni shtjelluar më tepër. Dhe ajo
12 çfarë duket sikur ka ndodhur këtu është që burimi ka qenë
13 media serbe, domethënë, nga media serbe shkon tek The
14 Humanitarian Law Centre, te Qendra e Të drejtës Humanitare,
15 pastaj ju e merrni citimin, e keni citimin si bazë atë çfarë
16 ka shkruar Qendra Humanitare e së Drejtës dhe më pas e citoni
17 sikur është burimi është i juaji.

18 Z. TIEGER: [Përkthim] Ju lutem duhet të jepni kohë
19 dëshmitarit që të shprehet.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
21 flisni me radhë.

22 Z. EMMERSON: [Përkthim]

23 PY. Atëherë, a e pranoni kronologjinë?

24 PË. Kronologjinë e raportimit?

25 PY. Kronologjinë që unë sapo ju shpjegova. A e pranoni këtë?

1 PË. Me disa dallime.

2 PY. Cilat janë dallimet?

3 PË. Në rregull. Së pari, dua që të kem ca sqarime të tjera.

4 PY. Doni që t'ju sqarojmë më tepër pyetjen se nuk po e
5 kuptoj?

6 PË. Po. Çfarë pyetje po bëni?

7 PY. Po ju pyes lidhur me parimet e bazës, themelit, ku e keni
8 burimin? Unë po ju them që ju reflektoni, pasqyroni diçka që
9 në raportin tuaj del si fakt ndërkohë që burimi i këtij
10 informacioni fillimisht ka qenë media serbe?

11 PË. Së pari, e filluat pyetjet duke thënë shteti serb dhe
12 tani po thoni diçka tjetër.

13 PY. Në qoftë se e thashë ju kërkoj ndjesë.

14 PË. Besoj se e thatë. Tani për t'ju përgjigjur pyetjes tuaj
15 së pari, dua të di se për cilën media bëhet fjalë, sepse në
16 punën tonë ne kemi bërë një dallim midis medias shtetërore --

17 PY. Ju kërkoj ndjesë --

18 Z. TIEGER: [Përkthim] Ka shumë mënyra që ndërpritet
19 dëshmitari.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson,
21 ju lutem prisni derisa ta mbaroj përgjigjen dëshmitari.

22 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk e ndërpreva.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E ndërpretë
24 në fakt.

25 DËSHMITARI: [Përkthim] Ne bënim dallim ndërmjet mediave,

1 sepse shteti kishte kontroll të fortë mbi disa media dhe
2 kishte ndërkohë edhe organe të tjera mediatike të cilat ishin
3 më të pavarura, të cilat ne i besonim më tepër, domethënë, për
4 të cilat ne vendosim më tepër besueshmëri. Kështu që, së
5 pari, dua të di se për kë media bëhet fjalë.

6 Z. EMMERSON: [Përkthim]

7 PY. Ju nuk thoni në raportin tuaj që burimi është një media e
8 caktuar ose media serbe apo ndonjë tjetër specifikim. Po ju
9 thoni që ky është citimi juaj, apo jo?

10 PË. Po.

11 PY. Ju thatë që përderisa bëhet fjalë për kolegë dhe për
12 derisa bëhet fjalë The The Humanitarian Law Centre ju kishit
13 shumë besim te konkluzionet e tyre apo tek metodologjia e
14 tyre, apo jo?

15 PË. Po, kishim goxha besim në metodologjinë e tyre.

16 PY. Po kishit goxha besim në profesionalizmin e tyre po çfarë
17 do të thotë në këtë rast, domethënë, që kishit besim në median
18 ku ishin mbështetur ata?

19 PË. Ky është thjesht prezumim nuk është se është besimi im.

20 PY. Dhe megjithatë ju e bëni sikur është deklaram faktesh ajo
21 çfarë pasqyroni në raportin tuaj, apo jo?

22 PË. Ne kishim një nivel të lartë besime në The Humanitarian
23 Law Centre ne besonim se ata kishin arsye për të përfshirë atë
24 çfarë kishin përfshirë në raportin e tyre. Unë nuk mbaj mend
25 ndonjë bisedë ose nuk mbaj mend që hulumtuesit apo autorët e

1 raporteve të tyre të kenë folur me ta për sa i takon këtyre
2 rasteve konkrete.

3 PY. Apo juve thjesht i merrnit faktet, që i mendoni si fakte
4 të tyre dhe thjesht i merrnit copëza-copëza dhe pastaj
5 shkruanit raportin tuaj, apo jo?

6 PË. Nuk pajtohem me vlerësimin tuaj.

7 PY. Megjithatë më lejoni t'ju bëj këtë pyetje. Nuk besoj se
8 është e nevojshme që të paraqesim këtë pjesë, këtë paragraf.
9 Pra, është deklarata që keni dhënë për ZPS-në që besoj që e
10 keni shkruar vetë për përgjigje?

11 PË. Për çfarë e keni fjalën?

12 PY. Për deklaratën që i keni dhënë Zyrës së Prokurorit të
13 Specializuar për këtë proces gjyqësor.

14 PË. Po, versionin fillestar e kam shkruar unë.

15 PY. Do të lexoj paragrafin 13, që është data 20 prill 2020
16 dhe bëhet fjalë për paragrafin 13 të deklaratës së
17 dëshmitarit. Në të thuhet:

18 "Të gjitha hulumtimet e kryera nga Qendra Humanitare në
19 periudhën nga 1990-1999 të gjitha këto hulumtime kishin një
20 metodologji të përbashkët me atë të tonën. Hulumtues të
21 trajnuar dhe me përvojë kanë intervistuar viktimat dhe
22 dëshmitarë të abuzimeve zakonisht në intervista të gjata kokë
23 më kokë. Burime të shumta me prova mbështetëse kërkohen për të
24 bërë pretendime të besueshme dhe The Humanitarian Law Centre
25 ka qenë e kujdesshme sa i takon bërjes së pretendimeve

1 publikisht. Kur ishte e mundur ne jemi përpjekur që të marrim
2 dëshmi ose të dhëna nga kryesit e pretenduar qofshin ata në
3 emër të një qeverie ose të një aktori jo shtetëror”.

4 Domethënë, kjo është deklarata sa i takon metodologjisë
5 për përgatitjen e raporteve tuaja për sa i takon vlerësimin të
6 besueshmërisë së burimeve apo të fakteve që keni pasqyruar ju.

7 Ne sapo pamë këtë shembull të fundit ku ajo çfarë keni
8 bërë ju nuk është asgjë tjetër vetëm një riciklim i raporteve
9 të lajmeve serbe në raportin tuaj dhe më pas citoni veten
10 tuaj. Domethënë, me fjalë të tjera, mbasi kalon koha ju nuk
11 bëni as përfshirjen e medias as përfshirjen e The Humanitarian
12 Law Centre po thoni që burimi jemi ne dhe jemi The Human Right
13 Watch.

14 Z. TIEGER: [Përkthim] E kundërshtoj përsëri. Vazhdohet me
15 komente. Është e nevojshme që të bëhet pyetja më shumë se të
16 bëhen komente të tejzgjatura.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
18 vazhdoni, z. Emmerson dhe bëni pyetjen.

19 Z. EMMERSON: [Përkthim] Unë mendova se ishte e qartë
20 pyetja.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] As unë s’e
22 kisha të qartë, kështu që besoj që as dëshmitari nuk e ka të
23 qartë.

24 Z. EMMERSON: [Përkthim] Në rregull.

25 PY. Pra, ju thoni në dëshminë tuaj që duhen disa burime për

1 të shkruar raporte dhe thoni po ashtu, pretendoni, që janë
2 bërë intervista të shumta me dëshmitarët por nga ana tjetër
3 këtë që thoni, këtë që predikoni nuk është se e keni të
4 përfshirë në raportet tuaja. Nuk është vërtetë kjo çfarë keni
5 bërë në realitet. Sepse sapo ju tregova që keni marrë burime
6 nga media pastaj media ka qenë burimi kryesor për një OJQ
7 tjetër dhe ju i jeni referuar kësaj OJQ dhe më pas keni thënë
8 që burimi i informacionit është i juaji.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem a
10 mund të bëni një pyetje të drejtpërdrejtë.

11 Z. EMMERSON: [Përkthim] Këto ndërhyrje nuk kanë si synim
12 që të lehtësojnë procesin po të më pengojnë mua. Do ju kërkoja
13 që të mos më ndërpritni të bëja punën time.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të
15 vazhdoni po nuk është koha këtu për të bërë deklarata dhe
16 fjalime.

17 Z. EMMERSON: [Përkthim] Nuk bëj fjalim këtu, po bëj
18 pyetje dhe unë po mundohen që gjërat t'i bëj të qarta.

19 PY. Dhe unë sugjeroj, Dëshmitar, z. Abrahams, se përdorimi i
20 këtij materiali nga një artikull lajmesh, domethënë, nga The
21 Humanitarian Law Centre në raportin tuaj nuk është në pajtim
22 me atë çfarë ju keni përshkruar si metodologjinë e punës tuaj,
23 pra, atë çfarë i keni thënë ZPS-së si metodologji e punës
24 tuaj.

25 PË. E kam përshkruar në mënyrë të vazhdueshme mënyrën sesi

1 jemi qasur kësaj pjese të raportit, besoj, që jepen 11 faqe,
2 domethënë, 11 faqe identifikohen metodologjitë nga një raport
3 me 130 faqesh. Ne citojmë burimet që kemi përdorur, kemi
4 diskutuar gjithashtu sesa e vështirë ishte që të hetoheshin
5 pretendimet për keqsjelljen e UÇK-së në atë kohë si rezultat i
6 frikësimit të personave si dhe mungesës së gatishmërisë ose
7 dëshirës së individëve ose personave për të folur për krime të
8 kësaj natyre.

9 Sipas mendimit tonë, mandati ynë është përmbushur përmes
10 mbledhjes të çështjeve dhe informacionit dhe burimeve të
11 besueshme. Nuk është se ne kemi marrë si burim vetëm The
12 Humanitarian Law Centre por kemi intervistuar gjithashtu edhe
13 UNHCR-në apo gazetarë të tjerë, kështu që kemi paraqitur dhe
14 burime të tjera në këtë pjesën prej 11 faqesh kur kemi
15 shpjeguar metodologjinë tonë.

16 Kështu që ne besonim atëherë, që kishte informacion të
17 mjaftueshëm, prejardhje të identifikuar të mjaftueshme të
18 këtyre burimeve për të mbështetur këto abuzime të pretenduara
19 anë mënyrë të tillë që njerëzit mund t'i ktheheshin këtyre
20 raporteve, siç ndodhë sot, për të ngritur shqetësimin që
21 persona të caktuar ishin zhdukur, siç e dimë edhe nga KNKK-ja,
22 që ka ende sot e kësaj dite, persona që nuk janë gjetur që
23 ende janë të zhdukur dhe për të theksuar që forcat serbe dhe
24 jugosllave ishin kryesisht përgjegjës. Ishin përgjegjës për
25 pjesën më të madhe të abuzimeve, megjithatë edhe UÇK-ja kishte

1 pjesën e vetë. Dhe ne besojmë që kemi dhënë informacion të
2 besueshëm në mënyrë të tillë që të mund të promovonim mandatin
3 e mbrojtjes civile.

4 PY. Ja të shoh pak se çfarë ke thënë:

5 "Përdorimi i atij materiali nga raporti i lajmeve përmes
6 Qendrës së Të Drejtës Humanitare në raportin tuaj nuk është në
7 përputhje me metodologjinë që keni përshkruar juve" kjo është
8 pyetja ime?

9 Z. TIEGER: [Përkthim] Ju përgjigj. Ju përgjigj pyetjes.

10 Z. EMMERSON: [Përkthim] Jo, nuk ju përgjigj.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përgjigjuni.

12 Z. EMMERSON: [Përkthim]

13 PY. Atëherë pyetja që kam për juve është kjo: A është në
14 përputhje me metodologjinë që keni përshkruar ju?

15 PË. Është metodologji tjetër.

16 PY. Atëherë i takon që kjo pjesë e deklaratës që keni thënë
17 nuk është e vërtetë, kështu?

18 PË. Ma lexon dhe një herë çfarë kam thënë në dëshmi, ju
19 lutem.

20 PY. Po, patjetër. Ti ke thënë si më poshtë:

21 "Të gjithë hulumtimet e kryera nga The Human Right Watch
22 në periudhën nga 1990 deri në 1999 kam përdorur të njëjtën
23 metodologji. Hulumtuesit e trajnuar kanë intervistuar
24 dëshmitarë dhe viktimë".

25 PË. Besoj që është në pajtim, është përputhëse me atë çfarë

1 kam thënë sepse përgjithësisht ne kemi ndjekur këtë lloj
2 qasjeje.

3 PY. Po ti nuk thua "përgjithësisht" "Zakonisht". Ti thua
4 "gjithmonë".

5 PË. A mund të ma tregosh të paktën këtë pjesë të deklaratës
6 time.

7 Z. EMMERSON: [Përkthim] Vazhdojmë që të nxjerrim
8 dokumentin. Është 075552.

9 PY. Pikë së pari, a identifikoni nënshkrimin tuaj këtu, z.
10 Abrahamas?

11 PË. Po.

12 PY. Është i juaji?

13 PË. Bazuar në faqen e parë po.

14 PY. Dëshironi të shikoni çdo faqe për të parë në është
15 nënshkrimi juaj?

16 PË. Jo, s'kam nevojë.

17 PY. Kalojmë tek 05556, paragrafi 30 [Sipas përkthimit]. Dhe
18 mund të lexoni katër fjalët e para të paragrafit 13.

19 "Të gjitha hulumtimet e bëra nga Qendra Humanitare për Të
20 Drejtën Humanitare mes 1990-1999 kanë pasur një metodologji të
21 njëjtë, hulumtues me përvojë dhe të trajnuar kanë intervistuar
22 viktimat dhe dëshmitarë për abuzimet me intervista të gjata,
23 burime të shumta me prova mbështetëse janë kërkuar për të bërë
24 këto pretendime të besueshme dhe The Human Right Watch ka
25 gabuar sa i përket kujdesit që duhet të kishte treguar".

1 Kjo nuk është përshkrimi i saktë i saktë i asaj që keni
2 bërë ju në shembullin që u tregua më herët.

3 Z. TIEGER: [Përkthim] Është e rëndësishme të shënohet që
4 në shënimin për dëshmitarin që i është dhënë Mbrojtjes të
5 qartësohet --

6 Z. EMMERSON: [Përkthim] Kërkoj. Nuk është ndërhyrje e
7 duhur për marrjen në pyetje nga ana ime që më takon mua të bëj
8 tani.

9 Z. TIEGER: [Përkthim] Me sa kuptoj unë, dëshmitarit po i
10 bëhen pyetje për kundërthënie mes metodologjisë që ai ka
11 përshkruar në deklaratën e tij dhe ajo që paraqitet në këto
12 raporte.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet
14 kundërshtimi.

15 Vazhdoni me pyetjen.

16 Z. EMMERSON: [Përkthim]

17 PY. Mund t'i përgjigjeni pyetjes. Pjesa që sapo kaluat nuk e
18 përshkruan saktësisht metodologjie që unë ju tregova sot në
19 mëngjes ku ju keni marrë diçka që është botuar në mediat serbe
20 pastaj nga Qendra për Të Drejtën Humanitare dhe pastaj citoni
21 Qendrën për Të Drejtën Humanitare si burim dhe e bëni tuajin.

22 PË. Mendoj, dua të bëj një dallim këtu sepse kur ne bëjmë
23 hetime lidhur me raste të caktuara ndjekim këtë metodologji
24 për aq sa kemi mundësi ta bëjmë. Dhe besoj se e shpjegova se
25 11 faqet e raportit të cilët i përmende që ju referove që

1 është ndryshe nga raportet e mëvonshme pastaj, që mbështeten
2 kryesisht në burime të dorës së parë. Ky raport ka përdorur
3 për raport, për arsye që i shpjegova më herët, burime të dorës
4 së dytë siç është Qendra për Të Drejtën Ndërkombëtare. Dhe kjo
5 shpjegon dallimin mes asaj që ju po nënvijëzoni dhe deklaratës
6 time këtu.

7 PY. E pranoni, që Gjykata të ketë mundësi të vlerësojë peshën
8 e raportit tuaj, që burimi i përdorur nga qendra për Të
9 Drejtën Humanitare duhet të ishte i rëndësishëm, do të jetë i
10 rëndësishëm?

11 PË. Kjo i përket Gjykatës të vlerësohet.

12 PY. Deklaratë që keni dhënë ju bazuar në Qendrën për të
13 Drejtën Humanitare ka dallim në qoftë se ata e kanë
14 intervistuar dëshmitarin intervistë të gjatë, pra, me të, kanë
15 pasur prova mbështetëse apo kështu-kështu apo në qoftë se
16 thjesht e kanë marrë këtë nga mediat serbe?

17 PË. Së pari, dua ta bëj të qartë se nuk pajtohem plotësisht
18 për me termin "mediat serbe".

19 PY. Ky është termi që është përdorur nga Qendra për të
20 Drejtën Humanitare.

21 PË. Ndoshta, por kjo është një lloj përshkrimi etnik dhe ka
22 një dallim mes mediave të ndryshme që janë të bazuara të
23 vendosura në Serbi dhe pikë që ku dëshiroj që të bëj një
24 dallim.

25 Z. TIEGER: [Përkthim] Dua të kërkoj ndjesë, por besoj që

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04408 (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson (Vazhdim)

Faqe 18

1 mirësjellja në Gjykatë janë rregullat e procedurës të tilla
2 duhet që të t'i kërkohet z. Emmerson që të lejojë dëshmitarin
3 të shprehet pa e ndërprerë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet si
5 kundërshtim.

6 Z. EMMERSON: [Përkthim] E pranoj që nuk është e duhur dhe
7 e vendit, por nuk e kuptoj sepse bëhet ky koment në këtë
8 moment.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sjelljet
10 tuaja fizike po ndërpresim vazhdimisht dëshmitarin. Ju
11 vazhdoni.

12 Z. EMMERSON: [Përkthim]
13 PY. Që të jemi të qartë lidhur me këtë. Mund të ketë, e
14 pranoj që ka media serbe të një cilësie të ndryshme dhe keni
15 të drejtë që e thoni këtu këtë gjë. Ne këtu po flasim për atë
16 media që keni përdorur ju si burim tuajin dhe burimi juaj ka
17 qenë Qendra për të Drejtën Humanitare dhe aty thuhet "Burimi:
18 Mediat nga Beogradi".

19 PË. Kjo është vend gjeografik dhe jo përshkrim etnik.

20 PY. Në qoftë se përdorim në pyetje të mia atëherë termin
21 media nga Beogradi, nuk ka një problem.

22 PË. Nuk bëhet fjalë që a jam me këto terme po ajo është
23 çështje që të jemi të saktë.

24 PY. Atëhere në rregull. Në qoftë se po reagon sepse thatë që
25 nuk ndiheshit mirë me përdorimin e këtij termi, për këtë e

1 bëra këtë pyetje.

2 Kthehemi dhe një herë këtu. Në qoftë se vjen nga mediat e
3 Beogradit në Qendrën për të Drejtën Humanitare Ndërkombëtare
4 është e rëndësishme të dijet gjatë vlerësimit të pretendimeve
5 faktike nëse ky është rezultat i metodologjisë që ju
6 përshkruat si The Human Right Watch apo intervistomi i
7 dëshmitarëve apo thjesht riciklim i diçkaje që vjen nga mediat
8 e Beogradit?

9 PË. Kërkoj ndjesë nuk e kuptoj pyetjen.

10 PY. Për sa i përket besueshmërisë së pohimit që ju jepni, a
11 pranoni që një pohim që behet pas intervistimit të një
12 dëshmitari ka më shumë gjasa të jetë i besueshëm dhe i vërtetë
13 sesa diçka që është riciklimi i një pohimi të mediave?

14 PË. Po.

15 PY. Pra, duke parë edhe një herë metodologjinë tuaj, siç e
16 përshkruat edhe ju, siç e lexove, a pajtohemi me mua, jeni
17 dakord me mua që, siç e biseduam edhe dje, përshkrimin në
18 raportin e 2001 që ju keni ndryshuar nga raporti i vitit 1998
19 nuk përputhet me metodologjinë që keni përshkruar.

20 PË. Do të thoja, po i referoheni raportit "Nën Urdhra" --

21 PY. Po i referohem dy përshkrimeve që dhatë ju. Në njërin,
22 merreshe si përshkrimi i një pretendimi nga fundi. Dhe keni
23 ndryshuar pastaj gjuhën që është përdorur që është pohimi i
24 faktit të një përgjegjësie kriminale të komandantit.

25 Pra, e pranoni që kjo është në mospërputhje me

1 metodologjinë që ju keni përshkruar? Sepse ju thoni, që të
2 jemi të saktë, "kemi gabuar në sa i përket kujdesit që duhet
3 të kishim treguar kur kemi bërë këto pretendime publike" dhe
4 pa patur ndonjë bazë, na thatë dje, keni bërë pretendime
5 konkrete pa patur ndonjë informacion të detajuar.

6 PË. Nuk do të thoja që nuk kishim asgjë. Ka pasur persona që
7 ishin të zhdukur. Persona që janë akoma të zhdukur sot. Por
8 pranoj fjalinë, siç e biseduam dje, formulimi në raportin "Nën
9 Urdhra" ishte ndërtuar keq.

10 PY. Dhe jo në përputhje me mënyrën sesi keni përshkruar vetë
11 ju që duhet të jeni shumë të kujdesshëm dhe organizata sesi
12 punon?

13 PË. Nuk më -- këto dy fjali në këto dy rreshta në faqen 5093
14 të raportit do i bëja ndryshe --

15 Z. TIEGER: [Përkthim] Kërkoj ndjesë. Siç e kemi dëgjuar
16 nga z. Emmerson dhe dëshmitari, kjo pyetje është bërë dhe
17 përgjigjur disa herë.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet.

19 Z. EMMERSON: [Përkthim] Vazhdojmë më tej.

20 PY. A ju kujtohet që e keni dhënë dëshmi në rastin
21 Milutinovic?

22 PË. Në përgjithësi, po.

23 PY. Do jem dhe unë i përgjithshëm, sepse me sa duket keni
24 mbyllur sytë për provat e The Human Right Watch në rastin që
25 ishte përpara gjykatës pra.

1 Ajo që po them unë është që disa nga materialet tuaja
2 janë produkt i hulumtimeve të mirëfillta dhe ne këtë e shohim
3 në veçanti për sa i përket hulumtimit që keni bërë në terren
4 me kolegët tuaj, z. Bouckaert, në Drenicë pas sulmeve të
5 tmerrshme në Obrinjë, ju keni qenë aty në terren në
6 vendngjarje që të nesërmen të masakrës së civilëve shqiptarë,
7 është e saktë?

8 PË. Saktë. Ka qenë dy ditë më vonë, më pas.

9 PY. A mund të na jepni një datë për këtë hetim? Kur keni
10 shkuar aty në Drenicë?

11 PË. Me sa më kujtohet vrasjet e familjes Delija kanë ndodhur
12 në 27 shtator, dhe më kujtohet vuajtja e familjes.

13 PY. A kam të drejtë, a mund të them që kjo ka qenë pjesë e
14 asaj që është përshkruar në mënyrë jo të duhur si ofensiva
15 serbe e shtatorit?

16 PË. Kjo ngjarje, këto vrasje, kjo vrasje masive ka ndodhur në
17 fund, në ditët e fundit të ofensivës serbe që kishte filluar
18 disa muaj më parë.

19 PY. Nuk e di a ju kam pyetur, por në kohën kur keni arritur
20 ju, kufomat ishin akoma aty, është e saktë?

21 PË. Disa prej kufomave më duket kanë qenë shtatë nga 21
22 viktimat ishin akoma aty.

23 PY. Kjo duhet të ketë qenë përvojë shokuese dhe e vështirë,
24 gjendje e tmerrshme kur arrin aty?

25 PË. Kam dhënë dëshmi biles për këtë.

1 Z. EMMERSON: [Përkthim] A mund të paraqesim në ekran
2 shkurtimisht, është në "Java e terrorit në Drenicë", që është
3 00753, "Një javë terrori në Drenicë".

4 PY. Në rregull. Do t'ju paraqesë dy tre pjesë.

5 Z. EMMERSON: [Përkthim] A mund të kalojmë tek faqja 25 e
6 raportit që duhet të mbajë numrin 0634959 në krye të faqes.
7 Kjo është pjesa që na duhet.

8 PY. Në qoftë se mund të fillojmë në fund të faqes do të lexoj
9 vetëm këtë pjesë dhe vazhdimin. Përshkrimi që jepet këtu
10 mendoj është përshkrimi i asaj që keni parë ju kur keni
11 arritur aty apo kur keni parë vendin pothuajse në kohë reale,
12 pra, përshkrimi i një situatë që keni parë aty në kohën në të
13 vërtetë.

14 PË. E keni fjalën për paragrafin e fundit?

15 PY. E kam fjalën në përgjithësi. Për shembull, paragrafin
16 paraparak janë vëzhgime që keni parë ju, mënyra sesi është
17 përshkruar:

18 "Aty ishte një strehim i përkohshëm pak më poshtë..."

19 "Këto janë vëzhgime, gjëra që keni parë në terren, pra,
20 nuk është e saktë, pra nuk është e bazuar në thashethem apo
21 raportime keni qenë vetë në terren, keni qenë pothuajse si
22 hetuesi i një vendngjarje. E keni bërë për qëllime të ndryshme
23 tjera, por mënyra sesi keni vepruar keni bërë aty dhe keni
24 qenë shumë i freskët.

25 PË. Besoj që metodologjia e përfshirë në këtë raport shpjegon

1 praninë tonë në këtë vendngjarje.

2 PY. A mund t'ia shpjegoni Gjykatësit ju lutem këtë?

3 PË. Po, ne kemi arritur në atë vendngjarje atë ditë apo të
4 nesërmen pas sulmit dhe kemi dëshmuar, kemi parë shtatë nga 21
5 kufomat në këtë vend në pyll ndërkohë që merreshin nga
6 personat e tjerë për t'u varrosur.

7 PY. "Nëse shohim pak atë rreth 15 metra më poshtë në një
8 rrugë pylli trupi i Aliut ishte në një strehim të përkohshëm
9 që familja Delija kishte ndërtuar në pyll, një kuadër kornizë
10 druri me një mbulesë ku mbuloheshin, pra, disa sfungjerë
11 dyshek".

12 "The Human Right Watch pa në mes një dyshek të mbushur me
13 gjak dhe një pjesë e trurit të njeriut që ishte aty".

14 Pra, ata ishin të fshehur aty?

15 PË. Po.

16 PY. "The Human Right Watch pa një dyshek që ishte mbuluar me
17 gjak dhe pjesë të trurit që ishin mbi dyshek në anën e majtë.
18 Sipas vëzhguesve diplomatikë" --

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
20 kaloni në faqen tjetër që të lexojmë.

21 Z. EMMERSON: [Përkthim]

22 PY. "Bazuar në atë që vëzhguan diplomatë dhe gazetarë që kanë
23 qenë në vend u interesova që të gjitha trupat ishin në pyll.

24 Trupi i Hava Delijaj, grua 62 vjeçare dhe Pajazit Delijaj 69,
25 u gjetën në çadër. Këto burime përshkruan Hava Delijaj që

1 kishte plagë nga arma e zjarrit në kokë dhe fytin e prerë.
2 Burimet diplomatike më tej vëzhguan se këmba e djathtë e
3 Havasë ishte pothuajse e shkëputur nga trupi. Mesa duket e
4 prerë me thikë. Koka e Pajazitit ishte pothuajse e prerë dhe
5 truri që mbulonte kafkën e tij që ishte afër trupit të tij”.

6 Zejnije Delijaj e përshkruajnë, Zejnije Delijaj më dha
7 përshkrimin The Human Right Watch që ato që kishte parë, që
8 gjetur ajo në çadër më 27 shtator. Pash trupin e Pajazitit i
9 shtrirë në bark poshtë dhe pjesë e kokës së tij që ishte e
10 shkatërruar, e shpërthyer, kjo ishte në anën e djathtë të
11 çadrës ku jeni përballë saj. Pra, këto janë gjëra që janë pa
12 dhe që ju i keni konstatuar vetë kur keni bërë përshkrimet
13 tuaja, saktë?

14 PË. Po, i kemi biseduar me ata individë që kishin shkuar aty
15 përpara nesh.

16 PY. Po, e saktë. Tani nëse kalojmë pak më larg më poshtë,
17 duhet të jetë faqja 29 më duket 364963. Poshtë titullit
18 “Zahide Delijaj dhe dy vajzat e saj...”. Jemi akoma në pyll me
19 të njëjtën familje, e saktë? Familja e gjerë.

20 PË. Familja Delija, po.

21 PY. Pra, Zahide -- shqiptohet Delija?

22 PË. Delijaj.

23 PY. “Zahide Delijaj dhe dy vajzat e saj Donjeta dhe Gentiana.

24 “Në vend në një zonë të pyllëzuar trupat Human Right
25 Watch pa dhe dhe tre kufoma të tjera. Zahide Delilaj 27 vjeçe

1 u gjet në cep të pyllit, me sa duket e qëlluar me armë ndërsa
2 përpiquej të largohej. Plumbi i kishte hyrë nga pjesa e prapme
3 e kokës. Zahide nuk kishte çorape, as këpucë, duke thënë që
4 ajo ndoshta ishte duke fjetur në kohën e sulmit në çadër. Dy
5 vajzat e saj ishin menjëherë pas saj. Vajza pesë vjeçe Donjeta
6 kishte plagë me armë që kishte hequr pjesën e djathtë të
7 fytyrës”.

8 Z. EMMERSON: [Përkthim] Kërkoj ndjesë.

9 PY. “Pesë vjeçare kishte plagë shkaktuar nga armë zjarri që
10 kishte hequr pjesën e djathtë të fytyrës. Gentiana shtatë
11 vjeçare e kishte pjesën e sipërme të kokës të hequr, mesa
12 duket nga një plumb”.

13 Pra dhe këtu nuk jeni ju që bëni një përmbledhje të asaj
14 që ju është thënë. Këto janë gjena që në fakt i keni parë vetë
15 dhe i keni shënuar siç i keni parë?

16 PË. Saktë.

17 PY. Dhe pjesa e fundit që desha të shikojmë është në faqen
18 26, K0364960, në fund të faqes. Këtu kemi Hamiden, Jeton,
19 Luljeta dhe Valmir Delijaj.

20 “Një grup prej katër kufomash u gjetën nga anëtarët e
21 familjes, vëzhguesit diplomatikë dhe gazetarët pak më larg nga
22 kjo proskë e vogël. Në këtë grup përfshiheshin një prej
23 viktimave më të reja të sulmit 18 muajsh Valmir Delijaj që
24 ishte vetëm 18 muajsh që u gjet me fytyrë të mbuluar me gjak.
25 Jeton Delijaj, një djalë nëntëvjeçar u gjet afër, me sa duket

1 me fyt të prerë nga fyti deri te buzët me thikë ose me plumb”.

2 Në intervistën e tij Imer Delijaj me The Human Right
3 Watch kur përshkruan sesi janë gjetur trupat.

4 Fillimisht, a mund t’ju pyes a ishin këto kufoma aty kur
5 shkuaat ju apo nuk ju kujtohet?

6 PË. Më duhet që t’i shoh këto raporte që t’ju jap më me detaj
7 që t’ju jap përgjigjet e sakta.

8 PY. A ju kujtohet që ke parë që trupat kufomat ishin aty apo
9 ishin hequr nga aty?

10 PË. Më kujtohet -- nuk më kujtohet a ka pasur beb, fëmijë të
11 vogël aty.

12 PY. Por ka patur trupa aty që kemi -- por ka pasur fotografi,
13 pra, që e thojnë një gjë të tillë.

14 Shohim përshkrimin e Imer Delijaj në fund të faqes.
15 Kufoma tjetër ishte ajo e Valmirit 18-muajsh, djali 18-muajsh
16 i Ademit kishte plagë në anën e djathtë të fytyrës e deri afër
17 mjekrës dhe në dorën e djathtë kishte një vrimë por jo
18 shkaktuar nga plumb dhe plagë të vogla të tjera në trup.
19 Kishte një medalje të varur në gjoks”.

20 Nuk do të bëj, nuk do insistoj që këto janë prova sepse
21 ju keni qenë në një situatë kur keni patur mundësi t’i
22 përshkruanit sepse ju ishit vetë aty pra, dhe që është
23 metodologji komplet ndryshe, pashë, nga ajo që raportohet nga
24 media e qartë, por dua që t’ju pyes ky hetim është kur keni
25 shkuaat aty, ka vazhduar ku hetim ka vazhduar për javë, për

1 disa javë, saktë?

2 PË. Po.

3 PY. Dhe në qoftë se mund të kthehemi tek faqja 63 aty
4 përshkruani sesi mediat serbe - dhe kërkoj ndjesë të përdor
5 këtë term që ndoshta mund të jetë ofendues - po kështu ju e
6 parashkruani në raport, bëhet fjalë për televizionin serb, në
7 qoftë se shohin në fund të kësaj faqeje.

8 Ky është titulli, këtu keni nën këtë titull keni
9 përfshirë edhe përgjigjet është si përshkruhet një përgjigje
10 të televizionit serb RTS dhe të tjera. Para termit që përdor
11 më herët media nga Beogradi, është kështu?

12 PË. Megjenëse ju po parashtruat këtë, këtu televizioni serb i
13 referohet televizionit shtetëror që është plotësisht ndryshe
14 nga mediat e pavarura. Dhe duke qenë se kam bërë hulumtime për
15 lirinë e mediave dhe kam publikuar raporte për mediat në
16 Serbi, besoj që është e rëndësishme që të bëjmë këtë dallim
17 dhe të respektojmë gazetarët e pavarur që kanë bërë punë
18 jashtëzakonisht të vështirë në regjimin e Miloseviçit.

19 PY. E pranoj plotësisht që ka dallim jashtëzakonisht të madh
20 mes mediave të pavarura dhe ato shtetërore në veçanti në disa
21 vende të caktuara. Dhe keni të drejtë, por në qoftë se më
22 lejoni, do të përdorim dallimin mediat e Beogradit.

23 Shohim mediat shtetërore.

24 "Programet informative, pjesa më e madhe e programeve
25 informative në televizionin serb zyrtar që është RTS që

1 kontrollohet nga qeveria sugjerojnë se masakra në Obrinjë
2 Gorinja është ose inskenuar nga mediat perëndimore ose nga
3 'terroristët' shqiptarë. Në lajmet e mbrëmjes RTS e ka
4 sugjeruar bile që familja Delijaj ishte fotografi e një dele
5 dhe që një gazetar e kishte paraqitur përpara".

6 A keni parë diçka të tillë ju?

7 PË. Nuk ka qenë e habitshme që të kishte propaganda të tilla,
8 por kur e kam parë vetë është shumë, shumë shqetësuese, shumë,
9 shumë nervozuese.

10 PY. Dhe pa insistuar shumë në hollësi ajo që keni parë është
11 një masakër civile nuk kishte mundësi që të ishte dëm i
12 paqëllimshëm, pra, nuk ishin vrasje të paqëllimshme. Natyra e
13 plagëve, mënyra e njerëzve siç ishin vrarë në mënyrë
14 sistematike, përfshirë aty të vjetër gra dhe fëmijë.

15 PË. Konstatimet tona në këtë hetim ishin që këto ishin
16 shkelje të rënda të ligjeve të luftës që kanë rezultuar në
17 vdekjen e këtyre civilëve.

18 PY. Dhe se mediat serbe, mediat shtetërore serbe pretendonin
19 që ky ishte krim i inskenuar, skenë krimi e inskenuar. Dhe në
20 paragrafin pak më poshtë thotë që hulumtimet The Human Right
21 Watch që kanë intervistuar media të pavarura në Serbi, siç
22 janë Beta, agjencia e lajmeve Beta dhe Radio B52 [Sipas
23 përkthimit] si dhe gazetarëve të shumtë ndërkombëtarë por nuk
24 janë investuar nga mediat shtetërore.

25 PË. Është e saktë dhe është e rëndësishme të theksojmë

1 dallimin mes mediave të pavarura dhe mediave shtetërore.

2 PY. A mund të kthehemi dhe një herë te ajo që është pranuar

3 si shembull i raportimit më të mirë e më të saktë të The Human

4 Right Watch. Në qoftë se bëhet një dallim kaq kritik mes

5 medias shtetërore, që pretendon që ishte një kukull dhe ishte

6 gjak i pavërtetë thjesht si ilustrim kjo dhe një media të

7 pavarur dhe duke marrë parasysh se media e Beogradit është një

8 term që i mbulon të dyja, nëse shohim raportet The

9 Humanitarian Law Centre e cila ka cituar median e Beogradit

10 nga e vlerësuat ju besueshmërinë e këtyre burimeve?

11 PË. Mbështetur në besimin që kemi ne, në metodologjinë e The

12 Humanitarian Law Centre e cila në vetvete mbështetet në

13 komunikimet që kemi pasur ne me ta, në bashkëpunimin me ta në

14 mënyrë të rregullt, si dhe njohurinë e dijes së parë që kishim

15 ne mbi mënyrën sesi kryenin ata punën.

16 PY. Por dhe mediat joshetërore në atë kohë ekzistonin në një

17 farë spektri. Ishin shumë herë më të pavarur, ishin më afër,

18 pra, edhe mediat e pavarura atëherë teknikisht ishin pranë

19 organeve shtetërore ishin pranë mediave shtetërore.

20 PË. Shteti kontrollon media të kontrolluara nga shteti dhe të

21 pavarura janë mënyra të panuancuara për mënyrën sesi

22 interpretohet.

23 PË. Po.

24 PY. Po ngjyrimi apo nuancimi është një mënyrë për të thënë që

25 edhe mediat e pavarura ishin pranë propagandës serbe.

1 PY. Kishte lloj-lloj mediash, të cilat kishin qëndrime të
2 ndryshme dhe në varësi të problematikave sa u përket shtetit.

3 PY. Pra, për të vlerësuar diçka duhet të kuptohet çfarë media
4 ishte kjo. Cila agjenci ishte kjo që publikonte raportin a nuk
5 pajtohesh me mua?

6 PË. Duke njohur burimin na ndihmon sigurisht që të vërtetojmë
7 sa e saktë ishte.

8 PY. Pra, ky është një shembull i shkëlqyer? Në qoftë se ka
9 qenë media shtetërore sipas jush nuk duhet të ishte e
10 besueshme?

11 PË. E saktë.

12 PY. Po në qoftë se do ishte një media ndërkombëtare e pavarur
13 dhe e fortë ju do mendonit se kishte më shumë të ngjarë që të
14 ishte e pavarur dhe të merrnit parasysht provat e tyre?

15 PË. Po. Të ngjarë ka që ta merrnim parasysht.

16 PY. Saktësisht. Po këtu kemi diçka, kemi një media shtetërore
17 por të ashtuquajtur të pavarur po ashtu pranë medias
18 shtetërore.

19 Z. TIEGER: [Përkthim] Në rrethana të tjera, mund ta kisha
20 lejuar këtë zhvillim, por kohën e kemi të kufizuar sot. Edhe
21 kjo çështje tani është trajtuar në mënyrë të përsëritur.

22 Dëshmitari i ka thënë disa herë në cilat fakte janë mbështetur
23 e ka shpjeguar disa herë këtë gjë.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kështu ka
25 ndodhur.

1 Bëni pyetjen. Po, po i afrohem fundit të kohës.

2 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po ju thashë që do e mbaroj para
3 pushimit të paradites. Po kemi një raport tjetër këtu.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptoj.

5 Z. EMMERSON: [Përkthim]

6 PY. Unë po ju pyes, po ju them këtë, ju keni cituar burimet
7 në raportin tuaj që personat nëse dëshironi t'i verifikonin
8 këto burimet. Këtë koment bëtë më herët ju. Pyetja ime është
9 kjo nëse thuhet thjesht "media e Beogradit" si mund të
10 verifikohet besueshmëria e burimit në këto lloj raportesh?

11 PË. Unë s'flas dot për The Humanitarian Law Centre edhe as
12 për vendimet që merrnin ata ose sesi i vendosnin
13 poshtëshënimet për materialet e tyre. Por ne kishim dhe ende
14 kemi shumë respekt dhe besim në punën që bënë kjo qendër, pra,
15 The Humanitarian Law Centre sepse e njohim metodologjinë e
16 tyre edhe e dimë që janë të pavarur sepse ata e kanë kritikuar
17 forcat serbe jugosllave për shumë, shumë vite dhe ata do të
18 merrnin vendime bazuar në materiale që ata i konsideronin si
19 materiale të besueshme.

20 PY. T'i kthehem për një çast çështjes së Milutinoviçit.

21 Z. EMMERSON: [Përkthim] Vendimi është në listën e
22 materialeve. Nuk e di a është nevoja që ta nxjerrim në ekran,
23 por sidoqoftë mund ta nxjerrim nëse është e nevojshme.

24 PY. Ju e dini që para se të jepnit dëshmi është bërë debat
25 juridik se cili prej raporteve tuaja do pranohej si provë, e

1 dini këtë?

2 Z. TIEGER: [Përkthim] E kundërshtoj këtë pjesë pyetjesh
3 sepse nuk ka bazë.

4 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po është pyetja ime e pyetjeve.
5 Kështu që nuk ka pse ta kundërshtoj tani. Ju akoma s'e keni
6 dëgjuar pyetjen time kështu që s'mund ta kundërshtoni.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni z.
8 Emmerson me pyetjen.

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] E pranoni kundërshtimin? Po çfarë
10 nuk është relevante?

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Diskutimi i
12 debatit juridik që përmendët ju përpara një çasti. Nëse doni
13 t'i bëni një pyetje të mirëfilltë bëheni thjesht pyetjen.

14 Z. EMMERSON: [Përkthim] Mirë kështu do ta bëj atëherë.
15 PY. Një minut ju lutem. Në dëshminë në këtë çështje
16 gjyqësore, a dhatë dëshmi lidhur me përgatitjen e këtij
17 raporti, raportit që sapo pamë, dhe si rezultat i kësaj ju
18 dëshmuat, si po dëshmoni dhe këtu, që ishte rezultat i
19 vëzhgimeve, konstatimeve personale dhe intervistave të
20 konsiderueshme me dy dyzina persona për një incident të vetëm,
21 domethënë, kur themi një incident i vetëm, flas për një
22 incident që kishte ndodhur apo një krim që kishte ndodhur, për
23 këtë keni intervistuar disa persona dhe hetimin që bëtë ju si
24 The Human Right Watch të cilin ju e përshkruat në raport ishte
25 një hetim që zgjati me disa javë.

1 Megjithatë sa i takon raportit "Nën Urdhra" kjo është
2 parë nga pikëpamja e të pandehurve serbë, se në këtë rast
3 ishte çështja kundër individëve serbë. Dhe ju keni thënë në
4 atë dëshmi, sa i takon pretendimeve tek raporti "Nën Urdhra"
5 kundër serbëve për krime që ishin pjesë e aktakuzës së
6 Milutinoviçit që do të thotë, ata që kishin qenë objekt i
7 krimeve këtu i kemi të përshkruar si viktima të krimeve kundër
8 njerëzimit në periudhën mars qershor 1999, ju keni thënë, pra,
9 këto intervista në disa raste ishin të shpejta. Keni
10 intervistuar, domethënë, persona po shpejt e shpejt, sepse
11 personat literalisht vinin me traktor nga kufiri dhe kishin
12 vetëm kohë ta pyesim nga je dhe pse po ikën?"

13 Kështu keni thënë ju në këtë rast. Kjo ka qenë dëshmia
14 juaj. A ju kujtohet kjo?

15 PË. Nuk më kujtohet dëshmia fjalë për fjalë. Po kjo ka
16 ndodhur kur ishim në pjesën veriore të Shqipërisë aso kohe
17 bashkë e me kolegët dhe intervistonim personat që po
18 largoheshin nga vendi.

19 PY. Pra, meqë vlerësimi i besueshmërisë së dëshmimeve është
20 pjesë e rëndësishme e punës suaj, ju e pranoni që ka një
21 dallim mes këtyre metodologjive. Pra, ka një dallim mes një
22 hetimi që zgjat me javë të tëra edhe një interviste që bëhet
23 me një person në një kohë shumë të shkurtër sa i takon
24 besueshmërisë dhe thellësisë së besueshmërisë së asaj që është
25 thënë?

- 1 PY. Ka dy dallime. Sigurisht një është dallimi sa i takon
2 kohëzgjatjes edhe tjetri është produkti që del nga ky hetim.
3 Në këtë rast, për rastin e parë patëm një raport të
4 hollësishëm ku e kishim mbledhur të gjitha informacionet, por
5 intervistat e bëra shkurtimisht me personat që po ia mbathnin,
6 që po arratiseshin bashkoheshin por ne nuk e përdornim atë
7 informacion për të paraqitur një raport mbështetur në atë që
8 na tha një person që ishte me nxitim dhe ishte i traumatizuar.
- 9 PY. Ky është shumë i rëndësishëm ky dallim. Pra, ju po thoni
10 që nuk do t'i përshkruanit ngjarjet që u përshkruan ata teksa
11 nxitonin shpejt e shpejt për të kaluar kufirin për të shkuar
12 në Maqedoni mbase. Pra, ju nuk do të përshkruanit ngjarje, po
13 përpiqeshit të kuptonit praktikën si është situata dhe në
14 qoftë se ngjarjet e tyre, rrëfimet e tyre, ishin në përputhje?
- 15 PË. Nëse duam të flasim për raste specifike.
- 16 PY. Jo. Nuk është nevoja. Po ju pyes për metodologjinë e
17 përgjithshme që ndiqnit ju.
- 18 PË. Në rastin e dytë të intervistave, këto intervista na
19 shërbenin për t'u bërë pjesë i një materiali tjetër,
20 domethënë, ishin copëza materialesh që ne i mbledhëm për të
21 krijuar një panoramë të asaj që kishte ndodhur.
- 22 PY. Po të flasim pak për dallimin çfarë bënit ju dhe çfarë
23 bën një hetues apo një gjykatë. Ju këto raporte nuk i bëni për
24 t'i përdorur si prova?
- 25 PË. Të përgatisnim çfarë?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04408 (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson (Vazhdim)

Faqe 35

1 PË. Raporte. Për shembull, raportin "Nën Urdhra", sepse ky
2 raport nuk ishte shumë i thelluar. Po unë po të them këtë, ju
3 kur bënit këtë punë, kur përgatisni raporte të tilla, këto
4 raporte nuk i përdornit që të përdreshin në një të ardhme si
5 prova për t'u përdorur nga hetuesit, siç do të bënte
6 normalisht një hetues në punën e vetë?

7 PË. Publikimi i raporteve të tilla kishte disa synime.
8 Qëllimi kryesor ishte mbrojtja e civilëve në kohëra lufte dhe
9 promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeri në përgjithësi.

10 Por përveç këtij qëllimi abrellë varet pastaj nga
11 situata. E para njëherë të informohet publiku, të ketë në
12 mënyrë që të rigjenerohet presion nga publiku.

13 PY. Presion për çfarë?

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mos e
15 ndërprisni. Lëreni ta mbarojë përgjigjen dhe pastaj bëni
16 pyetjen vijuese.

17 DËSHMITARI: [Përkthim] Mund të vazhdoj. Pra, donim që të
18 bënim presion publiku kundrejt politikbërësve në mënyrë që të
19 krijoheshin dhe të zbatoheshin politikat të cilat merrnin
20 parasysh të drejtat e njeriut. Pra, raportimi ynë këtë kishte
21 si synim kryesor.

22 Z. EMMERSON: [Përkthim]

23 PY. Mund të marrim dhe shembuj konkretë nëse dëshiron por, a
24 mund s'kishte dhe synim që të nxiste në një farë mënyre
25 prokurorët ndërkombëtarë që të hetonin këto raste?

1 PË. Llogaridhënia. Llogaridhënia është një nga qëllimet
2 kryesore të punëve tona.

3 PY. Po përveç llogaridhënies si term, ju, të paktën për
4 periudhën e 1998 deri në fund të luftës në qershor të 1999, ju
5 po i përdornit këto raporte që të nxisnit prokurorë të TPNJ-së
6 t'i hetonin këto pretendime?

7 PË. Saktë.

8 PY. Të cilat nuk po hetoheshin sidomos pretendimet sa i takon
9 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës?

10 PË. Ne i kemi mbështetur gjithmonë proceset ndërkombëtare
11 gjyqësore që të bënin hetime dhe të ndiqnin penalisht rastet
12 serioze të shkeljes së të drejtave të njeriut.

13 PY. Por ama puna jua nuk zëvendëson punën e një hetuesi. Por
14 thjesht të rrisni ndërgjegjësimin që ka gjëra që duhen hetuar.

15 PË. Puna jonë është të japim sa më shumë prova të besueshme
16 që kemi mundësi e të inkurajojmë politikbërësit që të krijojnë
17 politika ku të përfshihej llogaridhënia edhe vënia e
18 drejtësisë.

19 PY. Shohim një aspekt tjetër. Ka pasur dy fusha të
20 përgjithshme provash në këtë çështje. Ju keni dhënë dëshmi, po
21 jo në formë gjetjesh apo përfundimesh. Po ta eksplorojmë më
22 shumë bashkë.

23 E para, e kam fjalën për dëshminë lidhur me arsyet pse
24 disa dëshmitarë shqiptarë me të cilët keni folur ju, mund të
25 kenë pasur hezitim thatë ose kishin frikë ose se ishin besnikë

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04408 (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson (Vazhdim)

Faqe 37

1 ndaj kauzës ose të dyja të marra së bashku. Mund të shtojmë
2 dhe arsye të tjera në fakt pse një person nuk do të flasë.

3 Edhe e dyta, në qoftë se veprimet e qershorit, sulmet për
4 të cilat kishit dijeni edhe besoj se kolegu juaj më duket se
5 Ben Ward, mos e kam gabim, bëri një punë të dorës së parë dhe
6 bëri një hulumtim të hollësishëm sa u takon civilëve serbë dhe
7 të tjerët që ishin viktimë kur përfundoi teknikisht lufta dhe
8 refugjatët u kthyen në vendin e tyre. Dhe i dhatë një
9 përshkrim Trupit Gjykes dhe në raportin tuaj sa u takon
10 gjasave që të kenë qenë individë të cilët kishin inate të
11 vjetra, mëri të vjetra dhe pretendonin se ishin të UÇK-së dhe
12 i qepnin vetë ato emblemat e UÇK-së nëpër rrobat e veta apo
13 grupe të vogla pranë UÇK-së apo persona individuale pranë UÇK-
14 së apo komandantë të zonave. Këto janë opsionet që kemi
15 diskutuar dhe keni dhënë dhe mendimet tuaja lidhur me këtë.

16 Dhe unë do të doja që të shihnim procesin, sepse duhet
17 t'i zbërthejmë pak këto përgjithësime apo në përfundimet e
18 përgjithshme të cilat keni nxjerrë ju.

19 Shohim grupin e parë. Flasim për arsyet për dëshmitarët
20 shqiptarë apo për personat që keni intervistuar ju për faktin
21 që hezitonin të flisnin. Supozojmë, si fillim, njëherë ju nuk
22 e keni dokumentuar që ky nuk foli apo ky personi tha që nuk e
23 flasë? Nuk e keni pasur të renditur me numra cilët persona
24 shqiptarë ishin këta që hezitonin të flisnin, nuk e keni
25 dokumentuar në formë të numërtuar?

1 PË. Ne mbajtëm shënime për të pasqyruar punën që bënim ne në
2 terren.

3 PY. Po a i keni me numër sa persona keni folur ju në total
4 dhe sa prej këtyre personave nuk deshën të flisnin?

5 PË. Nuk bëmë analizë sasiore.

6 PY. Fiks këtë doja të thoja dhe unë. Prandaj thashë që duhet
7 të bëjmë një zbërthim. Por me çdo individ është e vështirë të
8 kuptosh në qoftë se vjen nga frika, a vjen nga besnikëria apo
9 nga të dyja bashkë?

10 PË. Sigurisht. Në disa raste ishte e vështirë ta përcaktoje
11 këtë.

12 PY. Në disa raste nuk ju flisnin fare edhe ndryshimi do ishte
13 në qoftë se do ju thonin që jo nuk flas unë me ty se unë jam
14 në anën e tyre ose në qoftë se ju ka thënë jo nuk flas dot me
15 ty se më kanë kërcënuar se do më vrasin. Ta ka thënë njeri apo
16 kjo ishte përshtypje jote?

17 PË. Është më e nuancuar se kaq. Ka më shumë ngjyrim se kaq.
18 Një person që nuk ndan informacion në vetvete mund të thotë
19 shumë gjëra. Mungesa e vullnetit për të treguar gjëra të lënë
20 të kuptojnë në formë jo verbale. Apo se është pjesë e punës
21 sime mbase që të kuptoj dhe të interpretoj kontekstin në të
22 cilin ne punonim.

23 PY. Po në qoftë se nuk është i gatshëm të diskutojë me ju
24 është shumë e vështirë të kuptosh ti cilat janë motivet?

25 PË. Ndonjëherë po dhe ndonjëherë jo.

1 PY. Fiks. Mund të themi kategorikisht që ka pasur persona që
2 keni ndeshur dhe ju gjykuat se motivi që kishin ata për të mos
3 bashkëpunuar me ju ishte frika? Ka pasur disa persona?

4 PË. Absolutisht që po.

5 PY. Po ka pasë persona në kategori të tjera, ku ju thoni, që
6 këta ishin shqiptarë dhe thjesht nuk donin të flisnin keq për
7 njerëzit e tyre? Po për këtë kategori ju nuk mund të thoni me
8 siguri kishin apo s'kishin gjë të keqe për të thënë?

9 PË. Këto ishin persona që besonin tek kauza.

10 PY. Po ju nuk e dini këtë apo fshihnin gjë ata. Po përpiqem
11 të të them që personat nuk po flisnin, nuk po ju tregonin
12 diçka që mund të dëmtonte njerëzit e tyre, këtë. Ose ju të
13 paktën supozonit që ata mund të kishin diçka për të thënë që
14 dëmtonte njerëzit e tyre.

15 PË. Për t'ju përgjigjur pyetjes suaj do ta marr në një
16 drejtim të kundërt, ne kemi pasur shumë raste, të paktën unë
17 kam pasur shumë raste, ku personat i ekzagjeronin gjërat, do
18 thosha të kundërtën biles, për shkak të kauzës. Dhe thonin
19 gjëra të tipit, thonin gjëra që e promovonin edhe tërhiqnin
20 vëmendjen tek vuajtjet që patën në të vërtetë shqiptarët dhe
21 në të vërtetë pati vuajtje, ama nuk tregonin si ishte situata
22 në terren. Prandaj në hetimet tona duhet të ishim shumë të
23 kujdesshëm dhe të kërkonim hollësi ku ishin, a panë gjë vetë,
24 a ishin fizikisht atje. Po kjo është një vështirësi që e
25 ndeshëm edhe kur dokumentuam abuzimet nga serbët dhe

1 jugosllavët.

2 PY. Jo, po përpiqem që të kuptojmë në këtë pikë të bëjmë një
3 llogaritje sasiore të problemit, pra, sa nga shqiptarët me të
4 cilët folët ju, se duhet të keni folur me mijëra, me qindra?

5 PË. Të paktën qindra.

6 PY. Sepse shumë kanë dhënë dëshmi për krimet kundër
7 njerëzimit që kishin kryer serbët. Pra, në këtë kontekst nuk
8 lindi ky problem.

9 PË. Jo, doli problemi.

10 PY. Pra kishin frikë se mund të kishin pasoja nga serbët? E
11 thanë këtë? Këtë po thoni?

12 PË. Jo, nuk po them këtë. Por për të bërë një vlerësim të
13 saktë të shkeljeve të të drejtave të njeriut ishte e nevojshme
14 të kuptonim vendndodhjen dhe veprimtarinë e grupeve të
15 armatosura në këtë rast. Tani e kemi konkretisht fjalën për
16 UÇK-në. Që shpesh, por jo gjithmonë, ne konstatojmë se në disa
17 intervista personat hezitonin dhe thonin: Jo, jo, ata nuk
18 ishin fare në këtë zonë. Kështu që ne duhet të eksploronim më
19 tej këto arsye.

20 PY. Na dhe një shembull të shkëlqyer. Ju nuk e dini, ju nuk
21 mund ta vërtetonit atë që thatë. Ju thatë, ju e dinit që ka
22 pasur UÇK në atë zonë dhe prandaj ju dilni në përfundimin që
23 ose dëshmitari s'e ka ditur, që unë besoj që nuk ka mundësi të
24 ketë qenë kështu, ose nuk ka dashur t'ua tregoj ju, që
25 s'kishin as për detyrim t'ua tregonin?

1 PË. Po. Dhe ndonjë herë ne përpigësim të thelloheshim në
2 intervistat tona.

3 PY. Unë po përpigë të kuptoj ata mbase s'kanë dashur t'u
4 tregojnë për lëvizjet ushtarake të UÇK-së kush ishte atje a si
5 ishte, pra, mbase nuk kishin gjë për të thënë sepse nuk kishte
6 lidhje me krime kundër njerëzimit?

7 PË. Në disa raste unë mund të kuptoja ose të dalloja që
8 kishte frikë, ekzistonte frikë. Ose e kanë thënë e kanë
9 shprehur ose më shumë e kanë shprehur në një mënyrë të
10 nuancuar të cilën nuk po e diskutoj më.

11 PY. Po "nuk do ta diskutosh"? Po çfarë do të thuash?

12 PË. Që ata nuk donin të flisnin për shpërdorim apo veprime të
13 pretenduara nga ana e UÇK-së.

14 PY. E kuptoj. Pra, ti po thua që njerëzit thonin që ka pasur
15 masakra të pretenduara nga UÇK-ja ose krime në këtë zonë dhe
16 ata ju kanë thënë që "S'dua të flasë për këtë gjë. Nuk dua ta
17 diskutoj me ju".

18 PË. Ose kështu ose thonin që "Nuk di gjë për këtë gjë".

19 Por mënyra ndonjëherë sesi komunikon tregon që ka pasur
20 një arsye.

21 PY. Po duhet të më shpjegosh se tjetër gjë është të thotë një
22 njeri që i di unë të gjitha po kam frikë të tregoj. Çfarë po
23 na thua? Si ua ka thënë ju dëshmitari "Nuk di gjë për këtë
24 gjë"? Si e vlerësoni ju këtë sepse ju po flisni për komunikim
25 jo verbal, ju thoni ka të ngjarë, ka gjasa, ju jepni vetëm

1 probabilitet.

2 Unë dua të më jepni një shembull si ka ndodhur, na e
3 ilustro? Ju jepnin ndonjë sinjal, a bënin ndonjë shenjë?
4 PË. Okej. Do t'i përgjigjem në një mënyrë të ndryshme
5 pyetjes, mënyra sesi mund ta shpjegoj unë. Mjedisi ka qenë i
6 frikshëm kuptohet duke pasur parasysh se kishte ndodhur lufta,
7 situata ishte e frikshme, ekzistonte frika.

8 Dhe nga përvoja që kisha unë nga 1996 deri në 2001, është
9 që hetimi i krimeve nga UÇK-ja ishte më i vështirë, dukshëm më
10 i vështirë. Që nuk është unike për Kosovën. Unë kam punuar në
11 zona të tjera ku ka konflikte të armatosura nëpër botë. Dhe
12 kjo për një sërë arsyesh qoftë besnikëria, frikësimi,
13 intimidimi, udhëzimet, mënyra sesi ishin kuptuar udhëzimet.
14 Personat në këto raste kanë më pak të ngjarë të ndajnë
15 informacione për, në thojza them, "për njerëzit e tyre".
16 Ndonjëherë ata nuk pajtoheshin me sjelljen e tyre apo kishin
17 frikë se mos vendosnin veten në rrezik shpagimi nga forcat e
18 tjera. Për shembull, mos kryej veprime ushtarake pranë një
19 zone civile sepse ne na bën të cenueshëm, ne nuk mbrohemi dot
20 thonin.

21 PY. Kështu si e thoni ju po shpjegoni vështirësitë që keni
22 ndeshur ju që të merrnit panoramën e plotë sesi ishte jeta e
23 këtij komuniteti se lufta vazhdoi deri në qershor të 1999, po
24 pastaj ishin pasojat pas luftës dhe u desh shumë kohë që të
25 kishte rend publik në atë vend, kështu?

1 PË. Po, kështu.

2 PY. Dhe ju nuk po thoni që ka pasur një numër personash, pra,
3 kemi një numër personash që nuk ju jepnin ju informacion për
4 kryerjen e krimeve, këtë po sugjeroni ju?

5 PË. Unë besoj se kishte njerëz që nuk tregonin informacion.

6 PY. Nga mënyra sesi reagues ata kundrejt jush?

7 PË. Jo, ka pasur persona që e thanë që "Nuk do flasim për
8 këtë gjë". Unë e them me vendosmëri që ka pasur raste por nuk
9 ju jap dot një përqindje.

10 PY. Saktë. Fiks. Mund të jetë një rast?

11 PË. Jo, nuk është një rast. Nuk ka mundësi të jetë një rast.

12 PY. Dhjetë?

13 PË. Nuk jam unë në pozicion t'ju jap një shifër, por po ju
14 them në kuadër të punës që kemi kryer ne, kanë qenë më shumë
15 se dhjetë raste.

16 PY. Ju kërkoj ndjesë që duket sikur po ju ushtroj trysni, se
17 mbase po ju jap këtë përshtypje, por duam që Gjykatësit të
18 kuptojnë dëshminë tuaj. Ju hezitoni të jepni përqindjen e
19 shqiptarëve që keni intervistuar dhe të na jepni përqindjen e
20 atyre që ju kanë thënë diçka relevante për një krim dhe ata që
21 nuk e ndanin informacionin për shkak se kishin frikë apo se
22 ishin besnikë ndaj kauzës.

23 PË. Nuk e kuptova.

24 PY. Po ua lexoj edhe njëherë.

25 "...supozohet që nuk jeni të gatshëm të shpreheni, të na

1 jepni një pikëpamje sa i takon numrit të personave që keni
2 intervistuar, sa persona keni intervistuar ju dhe nga ky grup
3 që keni intervistuar sa ju kanë treguar diçka që kishte lidhje
4 me një krim por që nuk e ndanin këtë informacion sepse kishin
5 më shumë frikë sesa besnikëri".

6 Z. TIEGER: [Përkthim] Pyetja është bërë edhe është marrë
7 përgjigja.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim]
9 Kundërshtohet. Përgjigjuni.

10 DËSHMITARI: [Përkthim] Po nuk ju jap dot një llogaritje
11 sasiore.

12 Z. EMMERSON: [Përkthim]

13 PY. Po një përqindje?

14 PË. Nuk jam në pozicion t'ju jap as përqindje.

15 PY. Të shohim aspekte të tjera. Unë nuk po them që dëshmia
16 jote nuk është e rëndësishme, sigurisht që ka peshën e vetë.

17 Dua t'ju pyes tani sa i takon një qasje të ngjashme për
18 praktikën që keni shpjeguar ju bazuar në hulumtimin e Ben Ward
19 lidhur me keqtrajtimin e serbëve dhe pakicave në kohën kur po
20 kthehej një fluks i madh refugjatësh pas luftës. Po shoh që po
21 mbledh vetullat, për këtë, po doja të tregoja që për këtë
22 periudhë e kam fjalën.

23 A mund të paraqitet deklarata e dëshmitarit në ekran?

24 Z. EMMERSON: [Përkthim] E kemi bërë dhe më herët po do të
25 doja që të paraqitet sërish dhe të lexonim një fragment në të.

1 Për identifikim është dokument 07552.

2 Pra, është deklarata e dëshmitarit që hartuat vetë ju, e
3 keni shkruar vetë ju dhe që pastaj e keni diskutuar më tej me
4 ZPS-në në prill, është deklarata e prillit 2019.

5 Z. EMMERSON: [Përkthim] A mund të paraqisni paragrafin 79
6 ju lutem. Faqja 60.

7 PY. Në këtë paragraf ju thoni që:

8 "Kam rishikuar dhe kam redaktuar raportin e The Human
9 Right Watch që titullohet *Abuzime kundër serbëve dhe romëve në*
10 *Kosovën e re ...* që është shkruar nga Ben Ward. Në këtë raport
11 thuhet pjesërisht si më poshtë:

12 "Civilë shqiptarë kanë marrë pjesë në shumë prej djegieve
13 dhe plaçkitjeve të pronave serbe dhe rome ..."

14 Do ndaloj këtu. Me sa e keni kuptuar juve, domethënë, kur
15 flitet për civilët, "civilët" janë civilë apo jo? Këtë,
16 domethënë, persona që nuk janë të përfshirë në luftime. Kjo
17 është e drejtë besoj apo jo?

18 PË. Po.

19 PY. Pra, kjo nuk është pas luftës, kjo nuk ka lidhje me UÇK-
20 në? Ju thoni thjesht civilë.

21 PË. Jo, kjo nuk ka lidhje me anëtarët e UÇK-së.

22 PË. A pajtoheni me mua që ka pasur shumë civilë të përfshirë
23 në akte të tilla që nuk është se ishin pjesë e UÇK-së po që
24 ndoshta kishin besnikëri ndaj UÇK-së po pavarësisht kësaj nuk
25 kishin lidhje me UÇK-në.

1 PË. Ju keni më shumë informacion për këtë temë se mua.

2 Megjithatë një civil kur i merr armët civilë nuk është më
3 civil, nuk quhet më civil.

4 PY. Po këtu e keni fjalën për civilë 100 për qind apo jo, për
5 civilë të vërtetë në kuptimin e plotë të fjalës apo jo?

6 PË. Nuk janë anëtarë të UÇK-së në qoftë se e ke fjalën për
7 këtë.

8 PY. Po, për atë e kisha fjalën. Në rregull. Atëherë vazhdojmë
9 më tej.

10 "Kanë marrë pjesë në djegie dhe në plaçkitje të pronave
11 të serbëve dhe të romëve dhe në disa raste dhe në sulme të
12 dhunshme me fqinjët e tyre. Si refugjatët të kthyer shumë prej
13 tyre janë përfshirë në dëbimin e serbëve dhe romëve prej
14 shtëpive të tyre".

15 Kur e keni fjalën për "refugjatët e kthyer" e keni fjalën
16 përsëri për civilët apo jo?

17 PË. Për këtë kontekst po.

18 PY. Në rregull. Atëherë flasim për civilët që janë të
19 përfshirë në shumë nga aktet e djegies dhe plaçkitjes dhe disa
20 prej tyre në sulme të dhunshme. Po flasim prapë për civilë të
21 cilët janë përfshirë në dëbimin e serbëve dhe romëve nga
22 shtëpitë e tyre, prapë për civilë bëhet fjalë apo jo?

23 PË. Po.

24 PY. Kur thua shumë prej tyre, në aspektin numerik, për në
25 aspektin e shifrave, sa mund të thoni? Për sa veta e keni

1 fjalën?

2 PË. Duhet që t'i kthehemi raportit për t'ju thënë një
3 përgjigje më saktë.

4 PY. Po besoj që ka dallim ndërmjet fjalës "shumë" edhe "ca",
5 apo jo?

6 PË. Po.

7 PY. Të paktën e vetmja gjë që mund të themi që këta kanë bërë
8 një kontribut domethënës. Ose civilët kanë qenë përfshirë në
9 mënyrë të konsiderueshme në këto akte që ju përshkruani. Është
10 e drejtë kjo ta them?

11 PË. Jam, pajtohem me ju këtu nuk është se jam kundra asaj
12 çfarë po thoni ju.

13 PY. A mund të themi se me aq sa ju kujtohet sa i takon
14 djegieve dhe plaçkitjeve dhe dëbimit të serbëve nga shtëpitë e
15 tyre a mund të themi që më shumë sesa gjysma e këtyre akteve
16 kryhej nga civilët apo jo?

17 PË. Më duhet që ta lexoj këtë raport të thellohem pak më
18 tepër në të për t'ju dhënë një përgjigje.

19 PY. Rastet më të rëndë të dhunës ishin dhuna kundër njerëzve,
20 vazhdoni në këtë paragraf dhe thoni që:

21 "Incidentet më të rënda të dhunës megjithatë janë kryer
22 nga pjesëtarë të UÇK-së".

23 PË. E keni fjalën për fjalinë e radhës?

24 PY. Po.

25 PË. Cila është pyetja?

1 PY. E keni fjalën këtu për dhunë kundër njerëzve apo kundër
2 pronës?

3 PË. Do më duhet që ta shikoj edhe një herë, megjithatë duke
4 parë paragrafin e kam përshtypjen që duhet të bëhet fjalë për
5 dhunë kundër njerëzve.

6 PY. Kur flisni "incidentet më të rënda", domethënë, ju thoni
7 që pjesa dërrmuese e incidenteve. Për çfarë shifrash bëhet
8 fjalë këtu? Doni të thoni më pak sesa dhjetë apo jo?
9 Domethënë, është shifër, domethënë, bëhet fjalë për një numër
10 një shifror apo jo?

11 PË. Nuk di t'ju them ekzaktësisht por besoj që është një
12 numër me një shifër të vetme.

13 PY. Ka një rast që përshkruhet në raport, kam përshtypjen që
14 bëhet fjalë për një çift në Prizren, ku bashkëshorti shkon për
15 të marrë diçka në treg, pasi ngacmohet nga persona që kishin
16 stema të UÇK-së dhe kur kthehet në shtëpi gjen gruan e vrarë,
17 Besoj që nuk i referoheni këtij rasti, apo jo?

18 PË. Nuk më kujtohet fare ky rast.

19 PY. Domethënë, e përgjithshmja e asaj çfarë po thua ti, në
20 qoftë se e kuptova drejtë, është që ka pasur disa incidente,
21 pra, konfliktet në vetvete kanë qenë të vogla në numra. Pra,
22 ka pasur disa konflikte të kësaj natyre ku besohej që ishin të
23 përfshirë pjesëtarë të UÇK-së dhe kjo mbase ka ndodhur për
24 shkak të uniformës, për shkak se ata njiheshin, a është e
25 vërtetë kjo?

1 PË. Me aq sa më kujtohet mua?

2 PY. Po.

3 PË. Ka pasur disa incidente më të mëdha, më të konsiderueshme
4 pas qershorit që përfshinin dhe sulme. Besoj që ka qenë një në
5 Fushë-Kosovë. Besoj, që ka pasë një rast në Graçanicë, po
6 ashtu nëse nuk gabohem. Ka pasur dy grupe, dy autokolona të
7 cilat gjithashtu janë sulmuar. Po ndonjë rast tjetër a ju
8 kujtohet?

9 PË. Nuk më kujtohet.

10 PY. Megjithatë ka pasur raste që ka pasur dhunë të rëndë
11 kundër individëve të kryer nga persona të cilët në mënyrë të
12 besueshme vlerësoheshin se ishin pjesëtarë të UÇK-së në qoftë
13 se mund të shprehesha kështu.

14 Tani e gjithë kjo ka ndodhur në një periudhë goxha të
15 ngjeshur nga data 12 qershor kur u fol për marrëveshjen për
16 tërheqjen e forcave serbe nga Kosova. Por sikurse e dini, në
17 shtator UÇK-ja u çorganizua dhe u çarmatos. Dhe raporti juaj
18 mban datën e gushtit, domethënë, ne po flasim për një periudhë
19 goxha të ngjeshur.

20 Po më thotë kolegu që e tundi kokën por për procesverbal
21 dua që ta thoni me gojë ta thoni "po".

22 Pra, po thoja që ne po mbështetemi në një periudhë kohore
23 të shkurtër, kemi tërheqjen e forcave serbe dhe pastaj siç e
24 dimë të gjithë në shtator UÇK-ja çarmatoset dhe shpërbëhet.

25 PË. Besoj që ka qenë 19 shtatori.

1 PY. Në rregull. 19 shtatori. Domethënë bëhet fjalë për një
2 periudhë tre-mujore vetëm.

3 PË. Po, pak a shumë po.

4 PY. Na e shpjeguat se gjatë kësaj periudhe kanë ka pasur
5 shumë dëmtime të pronave të civilëve të shkaktuar nga
6 refugjatë të kthyer e tjerë e tjerë. Megjithatë këto raste të
7 dhunës së kryer nga UÇK-ja. Për këtë dua të të bëjë disa
8 pyetje.

9 Së pari, besoj, se u pajtuat me ne lidhur me këtë
10 megjithatë po e pyes edhe njëherë. Është e vërtet apo jo se
11 për shkak se UÇK-ja në atë periudhë kishte realizuar
12 pavarësinë e Kosovës dhe këtë pjesën e diskutuam dhe më herët,
13 është e vërtetë që njerëzit pretendonin që ishin anëtarë të
14 UÇK-së ose pretendonin që kishin kontribuar për UÇK-në
15 pavarësisht që ndoshta një gjë e tillë nuk është se ishte e
16 vërtetë, apo jo?

17 PË. Besoj, se thashë që mund të ketë pasur raste kur njerëzit
18 janë sjellë si anëtarë të UÇK-së.

19 PY. Po ka pasur motive të ndryshme për njerëzit për ta
20 pretenduar një gjë të tillë kur u arrit liria, kur u arrit
21 fitorja dhe kur u tërhoqën forcat serbe. Sepse kur njerëzit
22 janë kthyer, sigurisht, domethënë, që kanë pretenduar dhe
23 sigurisht që donin që të thonin që ne jemi në anën e atyre që
24 luftuan dhe që siguruan fitoren, apo jo?

25 PË. Besoj se ka dy përgjigje për këtë pyetje. Së pari më

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04408 (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson (Vazhdim)

Faqe 51

1 lejoni të them që nuk ka pikë dyshimi se ka pasur individë që
2 e ekzagjeruan rolin e tyre në luftime dhe njëkohësisht, unë e
3 kam besuar atëherë dhe e besoj dhe sot e kësaj dite, se për ta
4 bërë kështu në mënyrë të vazhdueshme, në mënyrë të dukshme do
5 të ishte e rrezikshme sepse ata individë që vërtetë kishin
6 sakrifikuar jetën e tyre nuk do të toleronin pretendime të
7 tilla të pavërteta apo maskarada të tilla kur njerëzit
8 mundoheshin që të përfitonin nga popullariteti i UÇK-së.
9 PY. Në atë kontekst, ku njerëzit pretendonin të ishin më të
10 rëndësishëm sesa ishin. Unë nuk po sugjeroj që këta për
11 momentin që këta njerëz ishin përgjegjës për numrin e kufizuar
12 të incidenteve të vrasjeve, megjithatë përfundimi juaj është
13 që kishte prova të besueshme që ishin të përfshirë ushtarë të
14 UÇK-së. Megjithatë e vërteta është që njerëzit mund të hynin e
15 mund të dilnin nga UÇK-ja, mund të kyçeshin dhe të çkyçeshin
16 nga UÇK-ja. Kemi dëgjuar këtu në sallën e gjyqit dëshmitarë që
17 na kanë thënë që një ditë kyçeshin në UÇK dhe pastaj
18 çkyçeshin. Ju e di këtë gjë apo jo, këto janë gjëra që kanë
19 ndodhur?

20 PË. Nuk mund të flas lidhur me këtë. Nuk është e mundur për
21 mua për ta vërtetuar apo jo një gjë të tillë.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem bëni
23 një pauzë. Në qoftë se do shikojmë rreshtat 4 deri në 25 të
24 rreshtit të mëparshëm do ta shikoni që po e ndërprisni
25 dëshmitarin herë pas here. E kuptoj që e bëni në mënyrë të

1 pavullnetshme, nuk synoni që ta bëni një gjë të tillë, po kini
2 parasysh që çdo gjë këtu përkthehet dhe është shumë e vështirë
3 për përkthyesit që t'ju ndjekin.

4 Z. EMMERSON: [Përkthim] Po bëj më të mirën time.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ju kujtoj
6 për këtë gjë sepse është shumë e vështirë që të përkthehet çdo
7 fjalë që thoni në qoftë se flisni, në mënyrë të mbivendosur në
8 mënyrë të vazhdueshme.

9 Z. EMMERSON: [Përkthim] Në rregull. Vazhdojmë më tej, për
10 të kuptuar paksa qëndrimin tuaj.

11 PY. Po merremi me periudhën nga qershori deri në shtator në
12 këtë periudhë forcat e UÇK-së po ktheheshin në shtëpitë e tyre
13 ashtu si dhe civilët, e saktë është kjo?

14 PË. Po, e saktë është.

15 PY. Pra, kishim njerëz, kishit njerëz të cilët ishin në
16 procesin e të kthyerit në shtëpi, pra, ishin persona që kishin
17 qenë mbase pjesëtarë, ushtarë të UÇK-së, ndoshta në një pjesë
18 tërësisht të ndryshëm të Kosovës dhe po ktheheshin në shtëpitë
19 e tyre ku i kishin shtëpitë, kështu?

20 PË. Mendoj se përgjithësisht, po jo ekskluzivisht, ushtarët e
21 UÇK-së kanë shërbyer në ushtri ose në zona operative në afërsi
22 të zonave ku banonin, ku i kishin shtëpitë.

23 PY. Mirë. I kthehem përsëri deklaratës së dëshmitarit që i
24 keni dhënë ZPS-së. Në paragrafin 79 në citimin nga raporti The
25 Human Right Report nga mesi i këtij paragrafi ju thoni që:

1 "Incidentet më të rënda të dhunës, kanë ndodhur nga
2 pjesëtarët e UÇK-së. Megjithëse udhëheqësia e UÇK-së ka
3 nxjerrë një deklaratë më datë 20 korrik duke dënuar sulmet mbi
4 serbët dhe romët, ju vazhdoni që mbetet e paqartë në qoftë se
5 këto rrahje dhe vrasje kanë ndodhur nga njësitet e UÇK-së që
6 kanë qenë njësitet vendore të UÇK-së pa miratimin ose pa
7 sanksione zyrtare".

8 Pra, ajo çfarë thoni këtu apo çfarë doja që të shpjegonit
9 më tej për të kuptuar drejtë atë çfarë keni thënë si pjesë e
10 deklaratës tuaj është që nuk është e qartë.

11 Në qoftë se këto vrasje dhe rrahje kanë ndodhur pa
12 sanksione zyrtare të UÇK-së ose në qoftë se përfaqësonin një
13 politikë të bashkërenduar të UÇK-së.

14 Pra, kjo pika e politikave të bashkërenduara të UÇK-së
15 është diçka për të cilën do të dua të pyes më tepër. Na e
16 thatë tashmë që deri në këtë kohë kur po diskutojmë, në qoftë
17 se kishte autorizim për aktivitete për veprimtari në zonë,
18 komandanti i zonës do kishte kompetencën për ta autorizuar një
19 veprimtari të caktuar apo jo. Këtë gjena e thatë dje, apo jo?
20 Na shpjeguat sesa me pushtet ishin komandantët e zonës dhe si
21 rezultat gjëra të tilla ishin të decentralizuara.

22 Mendoj që nuk po sugjeroni sepse po thoni që nuk është se
23 bëni ndonjë pretendim për ndonjë krim të kryer nga ndonjë nga
24 zotërinjtë që janë këtu sallë gjyqi, pra, ju nuk po sugjeroni
25 që ka pasur një politikë të bashkërenduar të UÇK-së në nivelin

1 e Shtabit të Përgjithshëm? Nuk po e thoni këtë gjë, nuk po

2 bëni këtë sugjerim, apo jo?

3 PË. Çfarë thotë raporti është kjo, që në atë kohë ne e kishim

4 të paqartë se deri në çfarë mase këto sulme, kjo dhunë,

5 vrasjet dhe rrahjet ishin autorizuar nga forcat vendore ose

6 ishin kryer nga këto forca vendore apo në qoftë se ekzistonte

7 një politikë e bashkërenduar në qendër, përfshirë këtu edhe

8 Shtabin e Përgjithshëm. Aso kohe, ishte e paqartë. Në atë kohë

9 ne nuk kishim prova për të vërtetuar që këto ishin politika që

10 vinin nga Shtabi i Përgjithshëm.

11 PY. Për shembull, kur ju përmendi për z. Thaçi, ajo çfarë po

12 thoni është që ju mund të bëni deklarata të forta, pra, që ata

13 kanë bërë deklarata të forta sa i takon kritikimit dhe sa i

14 takon gjithashtu edhe individëve që kishin shkelur ligjin dhe,

15 duke përdorur fjalët e përdorura prej jush, kishte akte të

16 cilët ishin kryer nga persona të cilët dukej që kishin qenë të

17 veshur me uniformat e UÇK-së?

18 PË. Qëndrimi ynë atëherë dhe qëndrimi ynë sot e kësaj dite,

19 është që shpeshtësia dhe intensiteti i krimeve që kryhej në

20 atë kohë duhej të çonte në një përgjigje nga UÇK-ja ekzistuese

21 aso kohe sepse niveli i veprimeve të tilla ishte që i caktonte

22 barrën palëve në konflikt, megjithëse konflikti kishte

23 përfunduar në atë kohë, pra, e kishte barrën pala përkatëse,

24 pra, pala që ishte në fuqi që të paktën të bënte hetime siç

25 duhej në mënyrë të tillë që të merreshin hapat e nevojshme për

1 të minimizuar, për të lehtësuar e për t'u marrë me krime të
2 tilla për të trajtuar krime të tilla.

3 PY. Po këto gjëra ju i shpjegoni në faqen tjetër.

4 "Megjithatë çfarë është e padiskutueshme është se
5 shpeshtësia dhe sa të rënda ishin këto veprime i kërkonin
6 udhëheqësisë së UÇK-së ose i vendosnin barrën udhëheqjes së
7 UÇK-së që të merrnin hapa vendimtare për të ndaluar veprime të
8 tilla".

9 PË. Po

10 PY. Vazhdoni më tej në deklaratën tuaj, nuk e di në qoftë se
11 ju kujtoni atë çfarë ju pyeta dje lidhur me kualifikimin e
12 referimit të raportit Dick Marty në qoftë se jeni referuar,
13 pra, raportit Dick Marty. Dhe dua ta kuptoj pak më mirë këtë
14 që thuhet më tej në deklaratën tuaj. Ta lexojmë:

15 "Ky raport është hartuar duke përdorur të njëjtën
16 metodologji të përshkruar më sipër dhe unë besoj që ishte e
17 qartë kur është shkruar. Sa i takon fjalisë që mbetet e
18 paqartë në qoftë se rrahjet dhe vrasjet janë kryer nga njësi
19 vendore të UÇK-së që veprojnë pa sanksione zyrtare ose në
20 qoftë se përfaqësojnë një politikë të bashkërenduar të UÇK-së,
21 shkalla e koordinimit nuk ishte e qartë për mua atëherë, por
22 me kalimin e kohës u bë më e qartë nga një hulumtim tjetër,
23 përfshirë këtu edhe konstatimet e raportit të Marty".

24 Atëherë për të qenë i qartë, nuk jeni duke dhënë dëshmi
25 përpara Trupit Gjykses si dëshmitar ekspert, por ju e dini që

1 disa prej konstatimeve kryesore në raportin e Dick Marty, në
2 qoftë se -- atëherë do ta thoja në këto fjalë, që mbas
3 hetimeve për shumë vite, pra, konstatimet e raportit të Dick
4 Marty nuk janë ndjekur më tej. Për shembull, nuk ka prova apo
5 nuk ka asnjë pretendim në asnjë gjykatë, gjykatë të këtij
6 juridiksioni ose gjykata të brendshme dhe nuk ka fare asnjë
7 lloj pretendimi për trafikimin e organeve që ka qenë baza
8 kryesore ose akuza kryesore e raportit të Dick Marty.

9 Pyetja që kam për ju është kjo: Në atë kohë për ju ishte
10 e qartë që kishte material të pamjaftueshëm për të sugjeruar
11 që bëhej fjalë për aktivitet të bashkërenduar në nivel
12 politikash. Apo përpiqeni që ta rrëzoni këtë tani, nuk e keni
13 më këtë qëndrim?

14 PË. Përgjigja për këtë pyetje do kërkoj ta jap ca shpjegime.
15 Nuk e di në qoftë se mund të bëjmë një pushim?

16 PY. Varet sesa pushim doni? Pas dhjetë minutash, në fakt, unë
17 do bëj pushim në qoftë se do përfundoj në kuptimin që do i
18 përfundoj pyetjet e mia, në qoftë se dëshmitari kërkon pushim
19 për dhjetë minuta unë do kem përfunduar deri atëherë.

20 Tani ajo çfarë po të pyes është kjo, në atë kohë ky ishte
21 qëndrimi zyrtar i The Human Right Watch, kështu apo jo?

22 PË. Po.

23 PY. Sikurse është shpjeguar dhe në dëshminë tuaj, kështu?

24 PË. Po.

25 PY. Pavarësisht se çfarë ke mësuar ti që prej asaj kohe, kjo

1 që ke mësuar ti mbështetet në materiale që ka shkruar dikush
2 tjetër apo jo?

3 PË. Jo, nuk është e saktë.

4 PY. Na thuaj atëherë për çfarë e keni përmendur këtë
5 materialin shtesë?

6 PË. Po, me kënaqësi. Unë këtu them "hulumtime të tjera". Unë
7 këtu përmend një listë gjërash. Së pari, unë i referohem
8 kërkimit ose hulumtimit tim pas këtij raporti, pra, është një
9 raport i cili është botuar pas raportit të gushtit "Nën
10 Urdhra" që përfshin këtë informacion shtesë.

11 PY. Në rregull.

12 PË. Dhe aty përmenden krimet e UÇK-së. Dhe përveç kësaj unë
13 përmend edhe raportet e organizatave ndërkombëtare si për
14 shembull, e kam fjalën për raportin e OSBE-së, "Ashtu siç
15 është parë, ashtu është treguar" Volumi 2 që trajton abuzimet
16 e qershorit. E kam fjalën gjithashtu edhe të raportet Amnesty
17 International apo organizatave të tjera të besueshme
18 ndërkombëtare. E kam fjalën për raporte që kemi marrë nga
19 UNMIK-u, nga KFOR-i, që i janë referuar shumë qartë abuzimeve
20 nga UÇK-ja pavarësisht presionit politik nga udhëheqësia për
21 të mos fol me të. Sepse kjo është një çështje komplet tjetër.

22 Tani dëshiroj që të trajtoj diçka me të cilën nuk
23 pajtohem në përfundimet tuaja që përfshin gjithashtu edhe
24 raportin e Dick Marty. Dëshiroj të theksoj se raporti i Dick
25 Marty nuk ishte fundi i historisë. Raporti i Dick Marty çoi në

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04408 (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson (Vazhdim)

Faqe 58

1 krijimin e Task Forcës Speciale Hetimore të Bashkimit
2 Evropian, pra, ishte një rezultat i drejtpërdrejtë i TFHS-së.
3 Ju lutem më lejoni që të përfundoj, që është drejtuar nga një
4 diplomat i njohur amerikan, në fakt, një ambasador i krimeve
5 të luftës në Departamentin e Shtetit me emrin ose që quhet
6 Clint Williamson dhe gjithashtu ka shërbyer në Drejtorinë e
7 Drejtësisë së UNMIK-ut në vitin 1999.

8 Në qoftë se do shohim deklaratën përmbyllëse të
9 Williamson në TPNJ, besoj në 2014, thuhet shumë qartë se
10 konstatimet e tyre dhe, nuk dua që ta citoj dhe mund ta
11 kontrolloj dhe vetë, mund ta kontrollojmë bashkë deklaratën,
12 por ajo çfarë thuhet që gjetjet janë përgjithësisht në pajtim
13 me konstatimet e bëra në raportin e Dick Marty.

14 Që janë intervistuar qindra njerëz nga TFHS-ja. Atmosfera
15 e frikësimit ka qenë e pranishme. Atmosfera e krimeve -- ju
16 lutem më lejoni që të përfundoj. Dhe përderisa po flisni që
17 ngritët dhe çështjen e trafikimit të organeve çfarë kanë thënë
18 ata dhe po i referohem këtu SITF-së --
19 PY. Do t'ju ndërpres, për t'ju drejtuar Trupit Gjykues.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ju jap
21 vetëm pesë minuta.

22 Z. EMMERSON: [Përkthim] Jam i shqetësuar se tani
23 dëshmitari pëfshin edhe institucione të tjera të cilat kanë
24 qenë pararendëse të ZPS-së. Për shembull, Task Forca Hetimore
25 që ka qenë institucioni i parë ekzistues i ZPS-së.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04408 (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson (Vazhdim)

Faqe 59

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
2 përmbylleni.

3 DËSHMITARI: [Përkthim] Dëshmitar, ju po thoni që
4 pretendimet për trafikim organesh nuk është se janë më të
5 pranishme.

6 Z. EMMERSON: [Përkthim]

7 PY. Nuk po ndiqen më. Këtë thashë.

8 PË. Mendoj se TFHS nuk e i ka ndjekur këto pretendimi,
9 megjithatë ajo çfarë është akoma realitet është që ka ende mbi
10 400 persona të zhdukur që nuk janë gjetur fare. Domethënë, për
11 ta përmbyllur dua të them që hulumtimet tona kanë marrë
12 parasysh një tërësi dokumentacioni nga shumë organizata
13 ndërkombëtare.

14 PY. Për arsye të ndryshme nuk po futem në diskutime sesa me
15 vend është prezantimi i përfundimeve të Clint Williamson, nuk
16 do ta ndjek fare këtë pistë, nuk besoj se ia vlen. Vazhdojmë
17 më tej. Ajo çfarë po përpiqem që të vërtetojë me ju është se
18 në lidhje me këtë periudhë përshkrimi që jepet sa i takon
19 politikave koordinuese ju nuk jeni në një qëndrim që të
20 identifikoni qoftë edhe një incident të vetëm që përfshin
21 politikat koordinuese. Pra, nuk është se ka pasur shumë
22 incidente, megjithatë fliten për incidente që shkojnë nga 10
23 deri në 20 gjithsej, po nuk jeni në gjendje që të sugjeroni që
24 ato janë autorizuar në asnjë lloj niveli të UÇK-së. Pra, ato
25 mund jenë autorizuar nga ushtarë të rremë ose të paautorizuar

1 të UÇK-së. Mund të jenë autorizuar nga komandantët lokalë.
2 Mund të jenë autorizuar nga luftëtarët e rinj të UÇK-së, pra,
3 mund të jenë autorizuar në nivel zone.

4 Pra, unë po ju them që ju nuk jeni në gjendje që të
5 paraqisni asnjë provë që të vërtetoni ndonjë gjë tjetër përveç
6 kësaj që thashë, apo jo, nuk vërtetoni dot asgjë sa i takon
7 kësaj pike?

8 PË. Besoj se mbështetur në hulumtimet e akumuluar të cilat
9 janë prodhuar, janë botuar pa raportit të 1999, pasi i kam
10 lexuar këto raporte, unë kam arritur në përfundimin që ka
11 pasur një nivel të lart bashkërendimi dhe ky është përfundimi
12 që ne kemi arrit edhe në fillim fare.

13 PY. Nuk të takon ty që të mbërrish në përfundime që kanë të
14 bëjnë me faktin në qoftë se kishte një politikë qendrore apo
15 jo.

16 Çështja e fundit që do të doja që të trajtoja, do më
17 duhet pak kohë për ta trajtuar këtë. Megjithatë në raportet
18 tuaja, në raportin për shembull, "Nën Urdhra", ose raportet
19 për ndalimet, ngjarjet që ti përmend ose aktet e dhunës nuk i
20 përshkruan më si "krime lufte", por terminologjia që përdorni
21 janë "abuzime pas konfliktit".

22 A mund të na e shpjegosh pse keni ndryshuar gjuhën?

23 PË. Do më duhej që të shikoj raportet megjithatë e marr për
24 të mirëqenë që është kështu. E marr për të mirëqenë që është
25 ndryshuar formulimi. Nuk mund të flas për pjesë të caktuara

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04408 (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson (Vazhdim)

Faqe 61

1 sepse përndryshe do më duhej që të shikoj kontekstin, duhet
2 t'i lexoj. Por në një kuadër më të përgjithshëm, konflikti i
3 brendshëm i armatosur përfundoi më 12 qershor 1999.

4 PY. Në rregull. Dhe si rezultat bëhet i zbatueshëm e drejta
5 humanitare ndërkombëtare dhe të drejtat ndërkombëtare
6 njerëzore, apo jo?

7 PË. Po.

8 PY. Dhe The Human Right Watch e kupton domethënien ligjore të
9 tërheqjes pas Marrëveshjes së Kumanovës, apo jo?

10 PË. Po.

11 PY. Pra, që nuk kishte një trup ligjor të caktuar të
12 përshtatshëm që të mund të zbatohet në kuadrin e së drejtës
13 ndërkombëtare humanitare apo jo?

14 PË. Për krime që ishin kryer pas krimeve të pretenduara,
15 domethënë, pas qershorit të 1999. E aq sa di unë po.

16 PY. Për të përshkruar ose për shembull, në përshkrimin e The
17 Human Right Watch në një prej raporteve të shkruara që e
18 kishte bërë Carla Del Ponte që të përqendrohet tek krimet që
19 pretendohej që të ishin kryer dhe e ka bërë këtë gjë. Ka bërë
20 hetime të paktën në dy grupe rrethanash të ndryshme për
21 pretendimet për përfshirjen e UÇK-së. Në tetor të 2000, ju
22 besoj e dini, se ajo aplikoi në Këshillin e Sigurimit për
23 zgjatjen e mandatit të TPNJ-së, besoj se e dini këtë gjë apo
24 jo?

25 Z. TIEGER: [Përkthim] Dua që t'ju kundërshtoj tani sepse

1 kjo fushë nuk është me rëndësi, nuk është fushë për të cilën
2 mund të pyetet dëshmitari. Pra, kjo është diçka që bie nën
3 fushën e opinionit të dëshmitarit dhe për të cilën Mbrojtja
4 është ankuar gjatë gjithë kohës.

5 Z. EMMERSON: [Përkthim] A mund t'i përgjigjem? Atëherë së
6 pari ankesat tona për provat e opinionit janë kundërshtuar nga
7 Trupi Gjykses, kështu që, si rezultat, ne po zbatojmë thjesht
8 vendimmarrjen e Trupit Gjykses.

9 Dhe, së dyti, organizata që pretendon ekspertizë,
10 domethënë, kjo është një organizatë që pretendojmë që ka
11 ekspertizë, ka eksperiencë, në drejtën humanitare
12 ndërkombëtare. Dëshmitari pretendon se ka eksperiencë në këtë
13 fushë. Organizata arriti në përfundimin që konflikti i
14 armatosur ka përfunduar më 12 qershor dhe se çdo gjë më pas ka
15 qenë objekt i të drejtës humanitare ndërkombëtare.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem mos
17 flisni me këtë dëshmitar për çështje të tilla ligjore se ai
18 nuk është jurist.

19 Z. EMMERSON: [Përkthim]
20 PY. Në një prej raporteve që ju përmendni ku Carla Del Ponte
21 ka aplikuar për zgjatjen e mandatit të TPNJ-së, pra, e ka bërë
22 këtë kërkesën përpara Këshillit të Sigurimit të Kombeve të
23 Bashkuara pas vitit 1999, pas qershorit të 1999 dhe më pas ju
24 thoni që kur shpërtheu konflikti në Maqedoni. Ajo vendosi që
25 ajo kishte një zgjatje të mandatit sepse mandati i TPNJ-së

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04408 (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje të palës tjetër nga z. Emmerson (Vazhdim)

Faqe 63

1 lidhej me ekzistencën e një konflikti në armatosur, është e
2 saktë kjo?

3 PË. Nuk më kujtohet kjo konkretisht. Ky botim nuk më kujtohet
4 por dukej se është pajtim me punën tonë.

5 Z. EMMERSON: [Përkthim] Faleminderit shumë. Nuk kam
6 pyetje të tjera.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit,
8 Emmerson.

9 Do bëjmë një pushim tani për 30 minuta. Do kthehemi këtu
10 në orën 11.35.

11 Ju lutem shoqëroheni dëshmitarin jashtë sallës.

12 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë
14 pushin deri në orën 11.35.

15 --- Pauza fillon në orën 11.04

16 --- Seanca rifillon në orën 11.35

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.
18 Sekretare, mund të sillni dëshmitarin në sallë.

19 Z. Roberts, a e keni një ide sa kohë ju duhet?

20 Z. ROBERTS: [Përkthim] Kam një vlerësim shumë saktë. Në
21 fakt, s'kam asnjë pyetje.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis?

23 Z. ELLIS: [Përkthim] Pesë deri në dhjetë minuta.

24 [Dëshmitari vijon dëshminë]

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull, z.

1 Abrahams. Jemi gati të vazhdojmë. Pyetjet e radhës do të bëhen
2 nga përfaqësuesi i z. Krasniqi, z. Ellis që është në anën të
3 djathtë tuajën.

4 Pyetje të palës tjetër nga Z. Ellis:

5 Z. ELLIS: [Përkthim]

6 PY. Mirëmëngjesi, z. Abrahams.

7 PË. Mirëmëngjesi.

8 PY. Besoj ju bëhet qejfi t'ju them një kam një numër të vogël
9 pyetjesh, shumë pa pyetje dhe bazuar në dëshmi që keni dhënë
10 në vitin 2009 TPNJ, besoj.

11 Z. ELLIS: [Përkthim] Në qoftë se mund të më shfaqni në
12 ekran ju lutem nga IT-05-87.1 T3977 deri në T4052. Faqja më
13 duhet është faqja 4000, fillojmë kalojmë te rreshti 19.

14 PY. Këtu janë bërë disa pyetje lidhur me intervistat tuaja.

15 Dhe pyetja, të cilën uroj, shpresoj ta shihni në ekran thuhet:

16 "Dje na thanë që keni filluar intervistat me viktimat apo
17 dëshmitarët kanë filluar të regjistrohen në kasetë si fillim i
18 digjitalizimit. A mund të na thoni nëse në vitin 1998-1999 kjo
19 metodë është zbatuar në Maqedoni, Shqipëri dhe në Kosovë në
20 përgjithësi?"

21 Dhe përgjigja juaj ka qenë:

22 "Në përgjithësi, jo, nuk është përdorur".

23 Dhe në fakt është e saktë, apo jo?

24 PË. Po, është e saktë.

25 PY. Pastaj pyetja vazhdon më tej në faqen vijuese:

1 "Faleminderit. A dhanë viktimat dhe dëshmitarët deklarata
2 me shkrim dhe a u nënshkruan?"

3 Dhe pastaj përgjigja jote:

4 "Jo, kjo nuk është procedurë që zbatohet nga The Human
5 Right Watch".

6 Është e saktë edhe kjo?

7 PË. Po, është e saktë.

8 PY. Do të kthehem tek kjo çështje pak më vonë, por vazhdojmë
9 të lexojmë pak më poshtë në të njëjtën faqe, ju është bërë
10 pyetja për përkthyesin që e keni përdorur. Dhe përgjigja juaj
11 në fillim të rreshtit 7:

12 "Përkthyesit tanë ishin individë nga Kosova, shumica e të
13 cilëve në atë kohë punonin si gazetarë dhe pastaj kanë
14 vazhduar me karrierën e tyre si gazetarë profesionist në
15 mediat ndërkombëtare si, për shembull, Agence France-Press dhe
16 agjenci të tjera".

17 Dhe kjo është e saktë apo jo?

18 PË. Është e saktë.

19 PY. Pastaj ju është bërë pyetja lidhur me gjuhën që keni
20 përdorur për të bërë hulumtimet tuaja në Kosovë dhe që të mos
21 i përmendim të gjitha, besoj se është e saktë që përveç jush
22 askush nuk ka folur, nuk dinte shqip apo jo, është e saktë?

23 PË. Saktë.

24 PY. Dhe Ben Ward nuk ka ditur shqip kur ka punuar këtë raport
25 në Shqipëri?

1 PË. Saktë, as ai jo.

2 PY. Tani në qoftë se mund të kalojmë në faqen 4003. Nga fundi
3 i faqes, rreshti 21, pyetja.

4 "Viktimat dhe dëshmitarët që keni intervistuar ju a u dha
5 mundësi atyre të lexojnë deklaratat pasi e keni shkruar ju?"

6 Dhe përgjigja juaj ishte nëse e kanë ta rishikojnë, ne ua
7 kemi mundësuar këtë, por zakonisht nuk kanë kërkuar dhe kjo
8 rrallë ka ndodhur".

9 Dhe kjo është e saktë, apo jo?

10 PË. Po është e saktë.

11 Z. ELLIS: [Përkthim] Faleminderit, z. Gjykatës. Kaq
12 kisha. Këto ishin pyetjet e mia.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
14 shumë.

15 Pyetje nga Prokuroria.

16 Z. TIEGER: [Përkthim] Shumë shkurtimisht, z. Gjykatës.
17 Faleminderit.

18 Pyetje vijuese nga z. Tieger:

19 Z. TIEGER: [Përkthim]

20 PY. Dëshmitar, në faqen 104, 105 në transkript iu është bërë
21 pyetja për pikëpamjen tuaj që në 1998 komanda qendrore ka qenë
22 e vështirë të dallohej dhe është e saktë që nuk keni patur
23 mundësi që të keni qasje në dokumente të brendshme të UÇK-së,
24 pra, në qoftë se ka ekzistuar është e saktë?

25 PË. Po, e saktë.

1 PY. Dhe a është e saktë që nuk ju janë dhënë dokumente të
2 tilla si urdhra, raporte, shënimesh takimesh e tjera?

3 PË. E saktë.

4 Z. TIEGER: [Përkthim] Kaq kisha, z. Gjykatës.

5 Z. KEHOE: [Përkthim] A mund të bëj një pyetje në vijim të
6 kësaj pyetjeje në veçanti që sapo u bë?

7 Pyetje vijuese të palës tjetër nga z. Kehoe:

8 Z. KEHOE: [Përkthim]

9 PY. Vetëm një pyetje. Në vijim bazuar në pyetjet që
10 parashtruan nga z. Tieger, më duket gjatë fundjavës keni thënë
11 këtë në shënimin për Prokurorinë, keni thënë që keni patur
12 njohuri të kufizuar të dorës së parë për sa i përket zinxhirit
13 komandues?

14 PË. Kërkoj [e pakuptueshme] të UÇK-së, kujt i referohej "te
15 ne"?

16 PY. I referohem shënimit përgatitor që keni bërë me ZPS-në në
17 paragrafin 36 faqe 6, ku thoni keni patur njohuri të kufizuara
18 të zinxhirit komandues të UÇK-së, saktë?

19 PË. Në qoftë se keni mundësi ta shfaqni në ekran sepse nuk më
20 kujtohet, e do doja ta shikoja.

21 PY. Po.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj.

23 Sekretare, në qoftë se mund ta shfaqni në ekran dokumentin.

24 Z. KEHOE: [Përkthim] Unë mund ta lexoj këtë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më mirë ta

1 shfaqim në ekran. E keni faqen, rreshtin?

2 Z. KEHOE: [Përkthim] Faqja 36. Po e bëj në mënyrë më të
3 vjetër e primitive, pra, me letre në dorë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani është në
5 ekran.

6 Z. KEHOE: [Përkthim]

7 PY. Pra, aty shënohet ju jeni 0408.

8 "0408 konstatoj që njohuria e tij e dorës së parë e
9 zinxhirit komandues ishte e kufizuar dhe nuk mund të thonte më
10 shumë sesa kaq lidhur me këtë çështje".

11 Ai i thatë ju ZPS-së gjatë takimit që keni zhvilluar me
12 të më 1 shtator se njohuritë tuaj atë zinxhirit komandues të
13 UÇK-së njohuritë e dorës së parë direkte ishin të kufizuara?

14 PË. Po.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
16 Barthe ka disa pyetje.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kam disa pyetje.

18 Pyetje nga Trupi Gjykses:

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Mirëmëngjesi, z. Abrahams.

20 PË. Mirëmëngjesi.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Siç e thashë kam disa pyetje
22 për ju. Pyetja e parë është në vijim. Në intervistën tuaj me
23 ZPS-në shtator të 2019 dhe prill të 2020, keni thënë se:

24 "Në vitin 1998 çdo shqiptar që punonte për shtetin serb
25 mund të konsiderohej si kolaborator. Të punoje jashtë

1 Prishtinës apo në zonat rurale ishte e rrezikshme”.

2 Kjo është për nevoja të procesverbalit, është 075552 në
3 075558, faqe 17, paragrafi 01.

4 A ju kujtohet z. Abrahams, që i keni thënë këtë ZPS-së në
5 2019, 2020?

6 PË. Po.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të sqaroni më në
8 hollësisht pse ishte e rrezikshme të punohej për shtetin
9 jashtë Prishtinës dhe pse kishte dallim nëse personi shqiptar
10 punonte në Prishtinë apo jashtë Prishtinës në atë kohë, cili
11 ishte dallimi?

12 PË. Po. Në përgjithësi të punoje për shtetin serbin,
13 pavarësisht që mund të bënte personi, po në veçanti shërbimet
14 e sigurisë, po jo vetëm, perceptohej shihej në përgjithësi si
15 akt pandershmërie, tradhtie. Dallimi që po përpiqem të bëj mes
16 Prishtinës dhe zonave të tjera, rajoneve të tjera është jo, se
17 dhe në Prishtinë nuk ishte problem, vazhdonte të ishte problem
18 edhe në Prishtinë, por në përgjithësi krahu i armatosur dhe
19 lëvizja e armatosur e UÇK-së ishin të pranishëm dhe më aktivë
20 jashtë Prishtinës dhe ishte jashtë Prishtinës kishte më pak
21 mbrojtje, prani më të vogël ndërkombëtare, besoj që po flasim
22 për 1998. Sepse në vitin 1998, sigurisht pas marsit të
23 ngjarjeve në Drenicë, kish një vëmendje të madhe ndërkombëtare
24 me shumë njerëz në Prishtinë diplomatë, gazetarë, përfshirë
25 dhe mua këtu dhe shumë të tjerë dhe kjo prani më e vogël në

1 rajone të tjera, në qoftë se kjo u përgjigj pyetjes tuaj.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po, faleminderit. Në
3 paragrafin vijues të intervistës tuaj në ZPS, paragrafi 82,
4 keni thënë si në vijim po citoj, besoj s'ka nevojë ta shfaqim
5 në ekran.

6 "Në veçanti pas Marrëveshjes së Kumanovës, akuzat për
7 bashkëpunim me armikun u shtrinë tek kategoritë të gjera tek
8 njerëzish. Nuk më kujtohet që personalisht që kam bërë ndonjë
9 hulumtim për shqiptarë që janë shënjestruar apo vrarë, por kam
10 dëgjuar pretendime të besueshme frikësimi dhe dhune kundër
11 individëve që akuzoheshin se bashkëpunonin me shtetin serb".

12 Dhe së pari, pyetja ime është: Marrëveshja e Kumanovës
13 është bërë në qershor të 1999?

14 PË. Po.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe ju thatë z. Abrahams,
16 nuk ju kujtohet personalisht që të keni bërë ndonjë hulumtim
17 për shqiptarë që janë të shënjestruar apo të vrarë, por keni
18 dëgjuar për pretendime të besueshme frikësimi dhe dhune ndaj
19 individëve që akuzoheshin si bashkëpunim me shtetin serb.

20 Pyetja ime është: Nga i keni marrë këto pretendime dhe me
21 fjalë tjera cila është baza për deklaratë të tillë?

22 PË. Siç e thamë hulumtimi bazë është bërë nga kolegët e mi,
23 siç e thamë. Mendoj baza për përfundimet e mia në të cilat kam
24 arritur janë dy udhëtime për një periudhë të gjatë kohore në
25 Kosovë pas qershorit 1999. Besoj ka qenë në gusht dhe në

1 dhjetor. Këto janë biseda të zhvilluara me një gamë sërë
2 individësh, një gamë të gjerë individësh pra. Në atë kohë
3 ishim në kontakt, komunikim të afërt të ngushtë me aktivist
4 vendor, gazetarë vendor dhe ndërkombëtar, diplomat dhe anëtarë
5 dhe pjesëtarë të organizatave ndërkombëtare që vepronin në
6 Kosovë në atë kohë -OSBE-ja, Kombet e Bashkuara dhe NATO.

7 Dhe i kam dhënë rëndësi të madhe, të veçantë, pikëpamjet
8 e këtyre personave disa prej të cilëve kanë bërë hetime të
9 këtyre rasteve, këto organizata ndërkombëtare që prodhojnë
10 raporte, disa prej të cilave dhe flisnin në mënyrë informale
11 dhe me ushtarë të KFOR-it. Disa prej tyre kanë shprehur dhe
12 frustrimet e tyre, pra, paraqet pakënaqësi sepse po shihnin
13 shkelje që ndodhnin që ata besonin kryheshin nga pjesëtarë të
14 UÇK-së, por që organizata për të cilën punonin nuk ju
15 kushtonte rëndësi që të raportonin për këtë çështje.

16 Pra, ata i kanë ndarë këto informacioni me ne, na i kanë
17 dhënë neve këto informacione sepse kishin përshtypjen që ishte
18 një presion që të mos raportoheshin këto gjëra dhe unë
19 pajtohem me këtë. Dhe na e kemi përmend bilës këtë në raportin
20 tonë deklarata nga dëshmitarë të ndryshëm përfshirë dhe shefi
21 i UNMIK-ut Bernard Kouchner, i cili sipas mendimit tonë i ka
22 mohuar këto pretendime në mënyrë të pavend.

23 Kjo është baza që kemi përdorur për të arritur në
24 përfundimet tona.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Ju përmendët

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04408 (Vijon) (Seancë e hapur)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 72

1 organizata ndërkombëtare, ndër të cilat OSBE-në dhe të tjerë,
2 Kombet e Bashkuara, NATO, thatë që keni qenë në kontakt me OJQ
3 në atë kohë?

4 PË. Po, kemi qenë. Ne kemi qenë në kontakt me një sërë
5 organizatash ndërkombëtare përfshirë humanitare në atë kohë
6 nga UNHCR-ja, agjencia për refugjatë dhe shumë grupe të tjera
7 humanitare joqeveritare që ishin bashkëbisedues të rëndësishëm
8 për neve.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Prapë në
10 paragrafi 82, jemi akoma aty në deklaratën tuaj dhënë ZPS-së,
11 keni shprehur mendimin tuaj:

12 "...bazuar në vite hulumtimesh në Kosovë" siç thoni ju
13 "...kategori të ndryshme të njerëzve, varësisht nga të
14 rrethanave ata etiketoheshin nga UÇK-ja si 'bashkëpunëtorë,
15 kolaboracionistë'".

16 Dhe besoj keni bërë aty, renditur aty gjashtë kategori të
17 ndryshme kolaboratorësh të mundshëm, a është e saktë kështu?

18 PË. Kështu e kemi.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A mund të na sqaroni pak më
20 shumë këto kategori të ndryshme siç i keni quajtur ju?

21 PË. Po. Atëhere sipas mendimit tim, ata që ishin në rrezik më
22 të lartë ishin individë që kishin punuar si polic në kohën e
23 Serbisë apo në forcat e tjera të sigurisë të shtetit serb,
24 këta ishin qartësisht të shënuar, shënjestruar si
25 bashkëpunëtorë apo tradhtarë.

1 Niveli tjetër i radhës do të ishte ata që kanë punuar jo
2 për shërbimet e sigurisë po për shtetin në përgjithësi,
3 përfshirë edhe në funksione administrative, pozitive
4 administrative, pra, mund të ishin polic trafiku por edhe i
5 punësuar në një ministri apo një organ shtetëror.

6 Pastaj në vijim dhe, nuk a di sa mund të arrij në gjashtë
7 kategori, por në përgjithësi trajektorja që është ndjekur
8 bëhet fjalë pra, këtu kategoria e radhës për njerëz që kanë
9 kritikuar haptas hapur UÇK-në, politikën e tyre, praktikat e
10 tyre, janë shprehur kundër. Këta janë përfshinë këtu rivalët
11 politikë që kanë patur pikëpamje politike të ndryshme, mund të
12 ishin nga LDK-ja apo të tjerë dhe këta etiketoheshin si jo
13 patriot apo kundër kauzës.

14 Pastaj vijnë ata që jo detyrimisht kundërshtonin hapur,
15 publikisht, por nuk e kanë mbështet siç duhet dhe në qoftë se
16 ekzistonte kjo ide apo perceptim që ky person i caktuar nuk
17 mbështeste apo nuk ishte në mbështetje të plotë të kësaj kauze
18 përmes veprimeve apo fjalëve edhe ky person futej në këtë
19 etiketim ose në këtë listë.

20 Kategoria e fundit, kërkoj ndjesë në qoftë se nuk arrita
21 tek gjashta, ishte ekonomike. Edhe kjo ka qenë faktor në
22 mendimin tim, sepse kishte një shkatërrim rrënjësor të
23 ekonomisë së Kosovës dhe ishte një mundësi që një person të
24 pasurohej në mënyrë të ligjshme apo të paligjshme në një
25 mjedis kaotik dhe të çrregulluar. Sipas informacionit që kam

1 unë dhe kam bërë biseda me personat që më kanë treguar këtë
2 gjë, disa prej këtyre përplasjeve kishin arsye interesat
3 ekonomike dhe përpjekje për të marrë kontroll të pjesëve kyçe,
4 të rëndësishme të ekonomisë së Kosovës. Ka pasë raste ku një
5 person mund të ishte mund të ketë ndodhë të jetë etiketuar si
6 kolaborator me qëllim që të marginalizohet apo ndoshta në
7 raste të caktuara të eliminojë edhe fizikisht - nuk kam raste
8 të caktuara - për arsye biznesore, thjesht pra ekonomike.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] E kuptoj. Dhe vazhdojmë në
10 vijim me këtë, paragrafi 83 në deklaratën tuaj keni thënë si
11 në vijim dhe po citoj:

12 "Sipas vëzhgimeve të mia, asaj që kam parë unë, qëndrimi
13 ndaj kolaboratorëve të pretenduar ka ndryshuar, ndryshoi shumë
14 kur këta shumë persona, sepse pjesa më e madhe e këtyre
15 njerëzve u largua menjëherë nga Kosova, kur forcat jugosllave
16 dhe serbe u larguan, si e tillë ngacmimi frikësimi dhuna kaloj
17 tek persona që kishin funksione civile dhe kishin interesa
18 politik, ekonomik, financiar të ndryshëm".

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Është ky qëndrimi juaj?
20 PË. Po. Qartësisht personat që kanë punuar për shërbimet e
21 sigurisë janë larguar pjesa më e madhe janë larguar. E kanë
22 kuptuar që ishin të rrezikuar dhe disa prej tyre mund të ishin
23 edhe përfshirë vetë në kryerjen e krimeve të rënda dhe kanë
24 ikur, janë larguar. Pra, ky është ndryshimi që ka ndodhë pra.

25 Pjesa e dytë baza mbi të cilën që kam përdorë për të

1 kuptuar këtë janë bisedat, hulumtimet dhe koha që kam kaluar
2 në Kosovë gjatë kësaj periudhe kohore kur më thuhej në mënyrë
3 të përsëritur nga individë tek të cilët kisha besim dhe në
4 mënyrë jozyrtare, pra, nuk ishin intervista formale të The
5 Human Right Watch dhe më thonin, pra, që kishte përplasje të
6 fuqishme që po ndodhin për të kontrolluar sektorë ekonomik kyç
7 në Kosovë në atë kohë. Dhe çështja e kolaborimit apo
8 bashkëpunimit përdorej në këtë kontekst pra.

9 Nuk e di nëse kjo u përgjigjet pyetjes tuaj siç duhet.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit. Dhe një gjë të
11 fundit lidhur me këtë temë. Në paragrafin 84 të deklaratës së
12 ZPS-së keni përmendur "mosmarrëveshje mes komandantëve dhe
13 anëtarë me ndikim" siç keni thënë në UÇK se kush do të
14 kontrollonte bizneset në ekonominë e Kosovës, pra, pikat kyçe?
15 PË. Po.

16 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nga morët vesh për këto
17 mosmarrëveshje, apo ku u bazuat për të dhënë këtë pjesë të
18 deklaratës tuaj?

19 PË. Baza është informacioni që kam marrë një numër i gjerë
20 burimesh, qoftë nga KFOR-i, Kombet e Bashkuara, OSBE-ja,
21 hetues të tyre apo pjesëtarë, anëtarë të stafit të tyre.
22 Aktivistë, humanitarë. Sepse të gjithë po përpiqeshim të
23 kuptonim kontekstin në të cilin gjendeshim ne. Dhe në kuadër
24 të kësaj përpjekjeje ishte e rëndësishme që të përpiqeshim të
25 kuptonim çfarë ndodhi? Për shembull, ndodhi një ngjarje,

1 incident, çfarë ndodhi? A kishte ndonjë elementë përbërës të
2 drejtave të njeriut aty që ne si organizatë do ta shikonim
3 këtë ta analizojmë më afër? Dhe si përgjigje ndaj kërkesave
4 tona, hulumtimeve tona, ndonjëherë kemi kuptuar, kemi marrë
5 informacion që bëhej fjalë për konflikte të brendshme me
6 motivim dhe për arsye më ekonomike.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kjo është pyetja ime e
8 radhës. Në qoftë se keni më shumë informacion për këto
9 mosmarrëveshje, cilët komandantë ishin apo pjesëtarë me ndikim
10 ishin të përfshirë në këto lloj mosmarrëveshjes?

11 PË. Z. Gjykatës, nuk kam detaje, hollësi, me të cilat mund
12 t'ju jap sot, por jam i gatshëm që të shikoj më afër shënimet
13 për t'ju dhënë një përgjigje.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në rregull.

15 Kam dhe pyetje lidhur me takimet që keni pasur me z.
16 Thaçi në nëntor të 1998 dhe në gusht të 1999. Pyetja e parë
17 është kjo: Gjatë pyetjeve nga ana e Prokurorisë na thatë se z.
18 Thaçi dhe se z. Limaj apo personi që u prezantua si Çeliku të
19 tha që dy gazetarët serbë nuk ishin të pranishëm gjatë
20 gjykimit, kështu?

21 PË. Kështu.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju kujtohet se kush ua tha
23 nga këta të dy z. Thaçi apo z. Limaj, kush të tha që s'ishin
24 të pranishëm gjatë gjykimit?

25 PË. Do të doja të isha i saktë në këtë që do thoja, prandaj

1 më mirë të them që nuk më kujtohet 100 për qind, më duket se
2 z. Thaçi, po nuk jam 100 për qind i sigurt.

3 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Nuk ka problem. Në rregull.
4 Z. Thaçi apo z. Limaj a ju thanë arsyet pse nuk ishin të
5 pranishëm gazetarët gjatë gjykimit të tyre?

6 PË. Nuk më kujtohet të kem marrë ndonjë përgjigje për këtë
7 pyetje.

8 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A e bëtë ju këtë pyetje?

9 PË. Nuk jam i sigurt. Mbj mend që një e përgjithshme në vija
10 të trasha që morëm ishe çështja e sigurisë. Veçanërisht
11 sekreti ushtarak edhe kodi i sjelljes, na treguan kodin e
12 sjelljes. Folën për sigurinë edhe çështjet e sigurisë që vinin
13 që lidheshin me këtë.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Ju na thatë gjithashtu gjatë
15 pyetjeve nga Prokuroria se z. Thaçi dhe z. Limaj ju shpjeguan
16 ju personalisht dhe z. Bouckaert, se gazetarët nuk patën një
17 avokat që t'i përfaqësonte gjatë procesit.

18 PË. Po, e saktë.

19 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Do ju kujtohet kush ka qenë
20 z. Thaçi apo z. Limaj?

21 PË. Nuk më kujtohet.

22 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] A tha z. Thaçi apo z. Limaj
23 pse nuk patën një avokat gazetarët?

24 PË. Me aq sa kujtoj më thanë që ju dha mundësia që të
25 kontaktonin dikë dhe besoj se kjo është në një deklaratat e

1 mia ose të paktën e kam raportuar qoftë në raportin që është
2 publik apo në deklaratën time. Bënë një telefonat, kështu na
3 thanë, të paktën. Unë s'e di sa e vërtetë është kjo. Dhe
4 personi që telefonuan, që thirrën nuk erdhi.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po ashtu dje thatë se
6 kërkesa juaj për të vizituar gazetarët u rrëzua. Ju kujtohet
7 që e thatë?

8 PË. Po, kështu.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Sërish pyetja ime dhe, ju
10 kërkoj ndjesë që po përsëris veten, kush ua refuzoi kërkesën
11 z. Thaçi apo z. Limaj?

12 PË. Nuk jam i sigurt.

13 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në terma të përgjithshëm por
14 qoftë dhe konkretisht, si mund ta përshkruani marrëdhënien mes
15 dy personave, mes z. Thaçi dhe z. Limaj? A mund të thuhej, për
16 shembull, që njëri ishte në nivel epror apo ishin në nivele të
17 barabarta?

18 PË. Unë nuk mund të flas dot për rangjet që mbanin ata, po ne
19 u larguam nga takimi me përshtypjen se z. Thaçi ishte në nivel
20 më të lartë dhe kishte më shumë autoritet. Ai fliste kryesisht
21 gjatë takimit. Ndonëse nuk jam i sigurt nëse ishte ai personi
22 që u përgjigj pyetjeve nëse i kujtoj pyetjet që më bëre një
23 çast më përpara, po ai ishte folësi kryesor dhe kishte një
24 pozicion më me autoritet sipas perceptimit tonë.

25 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Besoj se gjatë seancës

1 përgatitore me ZPS-në, që është në paragrafin 24 të shënimit
2 përgatitor të ZPS-së, ju keni thënë një prej tyre merrte
3 shënime gjatë takimit, kështu?

4 PË. Kështu më kujtohet.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kush i merrte këto shënime,
6 cili prej të dyve?

7 PË. Besoj se z. Thaçi po nuk jam i sigurt. Më vjen keq nuk
8 mund t'i përgjigjem me saktësi kësaj pyetjeje.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Në rregull. Tani, z. Kehoe,
10 gjatë kundërpvetjeve, më duket se dje, të pyeti në qoftë se z.
11 Thaçi apo z. Limaj përmendën se një prej gazetarëve, prej të
12 ndaluarve, një prej gazetarëve serbë dyshohej si një person i
13 përfshirë në veprimtari kriminale në Republikën Serbe të
14 Krahinës së Bosnjës në vitin 1991 apo 1992. Ta përmendi
15 ndonjëri prej tyre?

16 PË. Jo. Nuk ka dalë kjo në takim.

17 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Tani kam disa pyetje sa i
18 takon takimit të dytë që keni pasë ju me z. Thaçi në zyrën e
19 tij në Prishtinë në 1999. Më duket se dje thatë që takimi u
20 mbajte në gjuhën shqipe. Takimi ishte me ndihmën apo pa
21 ndihmën e një përthyesi?

22 PË. Pa ndihmën e një përthyesi.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, gjatë gjithë bisedës
24 folët vetëm shqip jo anglisht?

25 PË. Pyetja shumë me vend. Me sa më kujtohet mua ne folëm

1 kryesisht në shqip.

2 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Pra, ishit vetëm ju
3 personalisht dhe z. Thaçi gjatë këtij takimi apo dhe të tjerë?
4 PË. Vetëm ne të dy.

5 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po nuk mund të na thoni nëse
6 ndonjë prej jush foli anglisht?

7 PË. Mbase ndonjë frazë, ndonjë shprehje, mund ta kemi thënë
8 në anglisht, por takimi u mbajt kryesisht në gjuhën shqipe.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Z. Thaçi në atë takim a ju
10 tha se nuk kishte kompetenca dhe përgjegjësia e tij të
11 trajtonte shkeljet e pretenduara të të drejtave të njeriut apo
12 shkeljen e të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut
13 nga pjesëtarët e UÇK-së dhe se mund t'ua çonit raportin në
14 lidhje me këto UNMIK-ut ose mund t'ua çonte ai raporte për
15 llogarinë tuaj.

16 PË. Nuk më kujtohet ta ketë dhënë një përgjigje të kësaj
17 natyre.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Gjatë takimit në nëntor të
19 1998 dhe në gusht të 1999, z. Thaçi, a ju tha çfarë do të
20 kishte bërë ai personalisht për të parandaluar rastet e
21 shkeljeve të të drejtave të njeriut apo të shkeljes së drejtës
22 ndërkombëtare të drejtave të njeriut nga pjesëtarë të UÇK-së
23 në të ardhmen?

24 PË. Me sa më kujtohet mua, ai i dënonte rastet e dhunës. Ai
25 theksoi faktin që respektonte të drejtën ndërkombëtare

1 humanitare konkretisht Konventën e Gjenevës. Dhe ky ishte
2 takimi i parë, por me sa më kujtohet, dhe në takimin e dytë
3 dhe ai i dënonte disa prej sulmeve që kishin ndodhur, më
4 konkretisht sulmi që ju kishte ndodhur 14 bujqve.

5 Sa u takon hapave konkretë, nuk më kujtohet të ketë dhënë
6 ndonjë informacion për masa konkrete që do të ishin ndërmarre
7 për të hetuar konstatimet tona apo për ta trajtuar më tej këtë
8 çështje.

9 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dhe kjo është pyetja ime e
10 fundit. Sikurse keni thënë gjatë seancën përgatitore me
11 Prokurorinë që është e reflektuar në paragrafin 35, nuk ka
12 pasur asnjë, kjo punë nuk është ndjekur as nga zyra e z. Thaçi
13 dhe as nga Qeveria e Përkohshme e Kosovës në atë kohë, kështu?
14 PË. Kështu.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kam unë një
16 pyetje.

17 Në takimin e parë me z. Thaçi dhe z. Limaj dhe kur po
18 diskutonit gjykimin e gazetarëve, përmendën gjë ata që një
19 gjykatës kishte marrë ndonjë vendim?

20 PË. Jo, nuk më kujtohet të kenë përmendur ndonjë gjykatës.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kaq kisha.
22 Gjykatësi Mettraux.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Edhe unë kam disa pyetje
24 për ju, z. Abrahams, lidhur me dy aspekte të dëshmisë suaj për
25 të cilën ku drejtuan pyetje palët. Një ka lidhje me rolin dhe

1 kompetencat e z. Demaçi dhe si i kishit kuptuar ju këto dhe
2 pjesa e dytë ka të bëjë me takimin e nëntorit 1998 me z. Thaçi
3 dhe me z. Limaj.

4 Do filloj me rolin dhe kompetencat e z. Demaçi dhe
5 perceptimin që kishit ju lidhur me këto. Nuk dua t'ua jap unë
6 sigurisht çfarë duhet të thoni, po a është e drejtë të themi
7 se mënyra si e kishit kuptuar ju aso kohe rolin dhe
8 kompetencat e tija, ishin më shumë që ai ishte një figurë e
9 UÇK-së, sa për pamje në UÇK dhe nuk ishte, në fakt, një person
10 me kompetenca vendimmarrëse i cili kishte ndikim apo që mund
11 të vendoste për veprimet dhe veprimtaritë e UÇK-së? A është
12 kjo e drejtë ta themi kështu?

13 PË. Po, i nderuar Gjykatës. Mendoj që përshkrimi juaj ishte i
14 drejtë. Unë nuk po them që ai nuk ishte pa asnjë lloj
15 influence sepse ai ishte një person i spikatur dhe ishte shumë
16 i respektuar.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Unë do të shoh, në fakt,
18 në këtë kontekst disa nga materialet që ua kanë treguar dhe
19 palët gjatë pyetjeve që bënë. Materiali i parë është P377. Z.
20 Abrahamas, kjo është pjesë e raportit të 1998.

21 Do i kërkoja Sekretares të shkonim në faqen 24
22 fillimisht. Ju faleminderit.

23 Shpresoj se ju kujtohet që jua lexuan dhe jua treguan
24 këtë pjesë të raportit që fillon më "18 tetorin" dhe pastaj
25 diskutohet fati i Radosevic dhe Dobricic. A ju kujtohet që ua

1 kanë treguar këtë pjesë të raportit?

2 PË. Po më kujtohet.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Me sa kujtoj unë këtë
4 pjesë të raportit e keni përgatitur ju, kështu?

5 PË. Kështu.

6 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të shohim faqen tjetër, që
7 është faqja 25, është një paragraf dhe unë do jua lexoj,
8 fillon:

9 "Më 27 nëntor, në nder të Ditës së Flamurit, UÇK-ja liroi
10 dy gazetarët në praninë e diplomatit të shteteve të Bashkuara
11 William Walker, i cili kryeson Organizatën për Siguri dhe
12 Bashkëpunim (OSBE) në Kosovë. Dy veprimtarë politikë etnikë
13 shqiptarë nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) në Malishevë,
14 Jakup Kastrati dhe Cen Desku të cilët kishin qenë të ndaluar
15 në objektin e UÇK-së për tre javë, po ashtu ishin objekt
16 amnistie. UÇK-ja komunikoi lirimin më 27 nëntor dhe tha se
17 amnistia tregonte angazhimin e UÇK-së ndaj konventave
18 ndërkombëtare të cilat trajtojnë luftërat".

19 Dhe pastaj vazhdon dhe thuhet:

20 "Më 24 nëntor UÇK-ja liroi një polic serb pas ndërhyrjes
21 së diplomacisë së SHBA-së".

22 Në qoftë se shkojmë dhe më poshtë ose më saktë desha të
23 thoja më lart. Është një poshtëshënim, poshtëshënimi 66 lidhur
24 me amnistinë.

25 E shihni, z. Abrahamas?

1 PË. Po e shoh.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Tani të shkojmë në fund të
3 faqes që të shohim poshtëshënimin që i përkon, këtu duket
4 sikur baza për këtë është një artikull në media i 27 nëntorit
5 1998 me titullin "Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së shpallë
6 amnistinë për dy reporterët e Tanjugut dhe dy veprimtarë të
7 LDK-së".

8 Pra, me sa kuptoj unë këtë keni pasur ju si bazë kur keni
9 përgatitur raportin, kështu?

10 PË. Me sa më kujtohet kështu është.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të shohim provën
12 materiale 1D47. Sërish, Abrahams, edhe këtë dokument ua kanë
13 treguar Ekipi i Mbrojtjes së Thaçit kur ju bënë pyetjet e
14 veta. Po ju jap mundësinë që të njiheni me materialin dhe pasi
15 ta keni lexuar më bëni me dije.

16 PË. E kam lexuar.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A është e drejtë të themi
18 që kjo është komunikata që keni marrë ju për bazë dhe pastaj
19 keni reflektuar në raportin tuaj?

20 PË. Po, kështu.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A nuk thuhet këtu që
22 amnistia në fjalë ishte dhënë nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-
23 së? Është e saktë ata e kishin dhënë?

24 PË. Saktë. Të paktën kështu e kam kuptuar këtë komunikatë.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po ashtu thuhet në

1 paragrafin e tretë, në përputhje me artikullin dhe me raportin
2 që ju keni cituar, këtu përmendet edhe angazhimi i UÇK-së,
3 mbase s'po përdor fjalë për fjalë siç është këtu, por që fakti
4 që UÇK-ja e njehë rëndësinë e konventave ndërkombëtare sa i
5 takon luftës dhe paqes, saktë?

6 PË. Saktë.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në paragrafin e parë,
8 fjalia e dytë thotë:

9 "Gazetarëve ju ndërpre vuajtja e dënimit..."

10 Pastaj kjo tregon, pra, kjo fjali tregon që në fakt ata
11 po vuanin dënimin, apo jo?

12 PË. Kështu e kam kuptuar unë.

13 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nëse e kuptoj unë siç
14 duhet dëshminë tuaj, kjo përputhet në fakt me atë që ju kishin
15 thënë dhe z. Limaj dhe z. Thaçi në takimin e 10 nëntorit të
16 1998, kështu?

17 PË. Po, më kishin thënë që ishin dënuar.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Një pyetje pak më e
19 përgjithshme. Jeni pyetur për burimet dhe si i keni peshuar
20 burimet e ndryshme që keni marrë. Çfarë rëndësie kishin këto
21 lloj komunikatash për ju, në qoftë se kishin ndonjë rëndësi,
22 nuk dua të përdor fjalën për "vlerë provuese", por çfarë
23 rëndësie, çfarë peshe u jepnit ju këtyre lloj dokumentesh?

24 PË. U jepnim shumë rëndësi këtyre komunikatave sepse
25 përgatiteshin nga strukturat zyrtare, në këtë rast të grupit

1 të armatosur. Pra, deklarata të përgatitura nga palët e
2 përfshira në konflikt, për ne, janë të rëndësishme, është
3 informacion i rëndësishëm pa asnjë lloj dyshimi.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shohim provën materiale
5 1D48 edhe këtë material ua kanë treguar nga ekipi i Mbrojtjes
6 së Thaçit. Këto janë shënime të pretenduara të z. Kurti, që
7 pretendohet se janë marrë nga z. Kurti, ku jepet pikëpamjet e
8 z. Adem Demaçi.

9 A mund t'ju kërkoj ju lutem të njiheni dhe ta lexoni edhe
10 njëherë paragrafin 5 të dokumentit.

11 PË. Po, e lexova.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Me sa kuptoj unë nga këto
13 shënime, z. Demaçi, ose të paktën z. Kurti shpreh pikëpamjet e
14 z. Demaçi që do të ishte "ide e mirë" që t'i lironin gazetarët
15 e Tanjugut. Dhe fjalia e radhës, ai shpreh pikëpamjen e tij që
16 "është mirë që lirimi të bëhet për festën e 28 nëntorit". E
17 shihni?

18 PË. Po, e shoh.

19 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A përputhet kjo me
20 pikëpamjet tuaja sa i takon rolit dhe kompetencave të z.
21 Demaçi që në qoftë se ai shprehte një dëshirë më pas lidhur me
22 këtë dëshirë vendoste dikush tjetër?

23 PË. Po, kështu e kam kuptuar edhe unë. Kështu e kam kuptuar
24 unë këtë material, kjo ishte pikëpamja e tij ose pikëpamja e
25 z. Kurti, që do ishte gjë e mirë që të bëhej kjo gjë.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shohim dokumentin me ERN
2 061427-11-TR-ET E Rishikuar. Thjesht për të dhënë kontekstin,
3 z. Abrahams, është transkripti i një konference për shtyp, e
4 kemi diskutuar, kur dy persona marrin pjesë në këtë konferencë
5 për shtyp. Është z. Adem Demaçi dhe Ibrahim Rugova.

6 Mund ta shihni nga përmbajtja që data i bie të jetë nga
7 fundi i nëntorit, por para lirit të z. Radosevic dhe
8 Dobricic, duhet të jetë java e fundit e nëntorit.

9 Do ju lutesha që fillimisht të lexoni paragrafin e dytë.
10 Është një deklaratë e z. Demaçi që u atribuohet z. Demaçi:

11 "Ju e dini gjithashtu se më datë 19 më ka ardhur një
12 letër në zyrën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Prishtinë
13 nga z. Milan Milutinovic. Ne kemi përgatitë edhe një përgjigje
14 për atë letër. Ne do të përpiqemi që gjithsesi të mbajmë
15 kontakte sepse zyra jonë në rend të parë dhe institucioni i
16 përfaqësuesit të përgjithshëm politik të Ushtrisë Çlirimtare
17 të Kosovës është themeluar që në rend të parë të mbajë
18 kontakte, të marrim kontakte me palën serbe sepse ne jemi në
19 konflikt me ta".

20 Tani pyetja ime është kjo, a përputhet kjo apo është
21 ndryshe nga botëkuptimi që kishit ju për rolin e z. Demaçi aso
22 kohe?

23 PË. Kjo përputhet me perceptimin që kisha unë për rolin e z.
24 Demaçi.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shkojmë në faqen 3 të

1 këtij dokumenti dhe do ju lutesha të shihni minutazhin

2 0:10:53. Minuta 10 sekonda 53. Gazetari bën këtë pyetje:

3 "Në vijim të lirimit të Goran Zbilic, familja dhe të
4 afërmit e Nebojsa Radosevic dhe Kico Dobricic, po shprehin
5 dyshimet nëse janë ende gjallë këta dy persona pavarësisht
6 deklaratave tuaja".

7 Me sa ju kujtohet, tek raporti ju përmendët dhe një polic
8 që është liruar më 24 nëntor. Ju kujtohet nëse është ky
9 personi që përmendet këtu, pra, Zbiliq?

10 PË. Ju kërkoj ndjesë, të nderuar Gjykatës, nuk më kujtohet
11 kjo gjë.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në rregull. Shohim
13 përgjigjen e z. Demaçi që është 00:11:08.

14 "Ju garantoj që ju dhe familjet tuaja, unë e kuptoj, unë
15 e di sa do shqetësoheshin nëna dhe motra ime për mua
16 pavarësisht se ato kanë mundësinë të më takojnë njëherë në
17 muaj. Unë e di ç'do të thotë të jesh në burg. Unë ju siguroj
18 që dy gazetarët në fjalë janë shëndoshë e mirë".

19 A përputhet kjo me atë që ju ka thënë z. Demaçi para se
20 të bënit takimin me z. Thaçi dhe z. Limaj, apo nuk ju ka thënë
21 asgjë lidhur me gjendjen e të burgosurve?

22 PË. Jo, përputhet.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në të njëjtin paragraf,
24 nga fundi i paragrafi ku thuhet "Sidoqoftë nuk jam unë
25 përgjegjës", z. Demaçi thuhet që ka thënë:

1 "Sidoqoftë nuk jam unë personi që mund të ndërhyjë me
2 këto çështje. Unë mund të ndërhyj vetëm si një njeri humanitar
3 dhe të bëj propozime të mira. Ju e dini shumë mirë që nuk
4 është në dorën time".

5 Dhe unë prapë do ju bëj të njëjtën pyetje, a përputhet
6 kjo me atë çka ju ka thënë z. Demaçi kur e ka e takuat që në
7 të vërtetë ai nuk kishte kompetenca vendimmarrëse sa i takon
8 fatit të këtyre personave apo ju ka thënë diçka ndryshe?
9 PË. Është në përputhje. Kur u largova nga takimi me z. Demaçi
10 u diskutua dhe kjo, pra, u largova me përshtypje të qartë që
11 ai nuk kishte autoritet për të liruar këta persona.

12 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Shohim faqen 5. Tek
13 minutazhi 19:25, do shihni që këtu po vazhdon diskutohet fati
14 i Goran Zbilic, të cilit gazetari i referohet si polici serb
15 dhe z. Demaçi thotë ai ishte një inspektor policie.

16 Dhe pastaj në paragrafin tjetër, 19:27, e pyesin, i
17 kërkonin të komentojë lidhur me lirimin e z. Zbilic dhe z.
18 Demaçi thotë kështu, 19:42:

19 "Unë nuk kam qenë aty kur z. Zbilic ka biseduar me juve.
20 Me qëllim nuk kam dashur të jem aty. Dhe unë u besoj juve
21 fjalëve të tij nëse vetëm këtë fjalë ka fol z. Zbilic. Kjo
22 shihet, që se Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Çlirimtare të
23 Kosovës ka vendosur të pranohet lutja ime, të pranohet
24 përpjekja ime që të kihet një mirëkuptim edhe për këta njerëz.
25 Më duket se është paguar 100 fish. Edhe sa u takon atyre

1 kërkesave të Shtabit të Përgjithshëm, është kërkesa gjenerale
2 që forcat serbe të mos provokojnë në vendet ku nuk ka serbë,
3 ku nuk kanë arsye që të vijnë”.

4 Edhe përsëri të bëj të njëjtën pyetje, kemi z. Demaçi,
5 këto janë fjalët e tij, fletë për një kërkesë që është bërë
6 Shtabit të Përgjithshëm dhe e cila është miratuar sa i takon
7 lirimit të këtyre personave, a përputhet kjo me atë që kuptuat
8 ju për rolin dhe pozicionin e tij?

9 PË. I nderuar Gjykatës, është përputhje me perceptimin tim
10 për rolin e tij.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në faqen e shtatë. Nëse
12 shohim minutazhin 28, minuta 28 sekonda 19, lexojeni vetë me
13 mendje fletë për diskutimet politike dhe formimin e një
14 qeverie. Përgjigja pastaj e z. Demaçi, pra, ndaj pyetjes së
15 gazetarit është kjo:

16 “...jo, unë kam autorizim nga Shtabi i Përgjithshëm i
17 UÇK-së që ta kryejë asamblenë, që ta krijojë qeverinë, që ta
18 krijoj grupin negociator”.

19 E njëjta pyetje: A përputhet kjo me mënyrën si e keni
20 kuptuar ju që z. Demaçi në fakt vepronte në bazë të
21 autorizimit nga Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së apo ju e keni
22 kuptuar ndryshe?

23 PË. Jo, përputhet me perceptimin tim.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju kujtohet, unë mund të jap
25 dhe referencën ku shfaqet kjo në raport, a ju kujtohet që ju

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: W04408 (Vijon) (Seancë private)
Pyetje nga Trupi Gjykses

Faqe 91

1 pyetën për ekzistencën e Burgut numër 7 dhe nga buronte
2 informacioni të cilët përdorët ju për të përmendur këtë burg?
3 PË. Po, më kujtohet.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do i lutesha Sekretares të
5 kalonim për një moment në sigurinë private në mënyrë që të
6 mbrojmë personin në fjalë.

7 [Seancë private]

8 [Seancë private teksti i fshirë]

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25

1 [Seancë private teksti i fshirë]

2

3

4

5

6

7

8

9

10

11

12

13

14

15 [Seancë e hapur]

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
17 jemi në seancë publike.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

19 Z. Abrahams, Dëshiroj t'ju pyes lidhur me diçka që keni
20 thënë, që ju ka thënë z. Thaçi ose z. Limaj përkatësisht që
21 UÇK-ja ishte një ushtri në rrugën e organizimit ose të
22 formalizimit, domethënë me fjalë të tjera, po organizonte
23 strukturat e veta. A ju kujtohet që u pyetët më herët lidhur
24 me atë se çfarë ka thënë z. Bouckaert lidhur me këto takim. Ju
25 kujtohen këto pyetje?

1 PË. Po, më kujtohen.

2 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dëshiroj që ta shohim edhe
3 një herë këtë deklaratë. Për Sekretaren, bëhet fjalë për
4 dokumentin U008-1, që është deklarata që ka dhënë kolegu juaj
5 z. Bouckaert. Dëshiroj që të paraqitet në ekran kjo deklaratë.
6 Do kaloj tek paragrafi që ju tregua dhe më herët. Në faqen 7,
7 Sekretares ju lutem. Atëherë së pari do i kërkoja Sekretares
8 që të paraqesë paragrafin 36.

9 Ju lutem, hidhini një sy për një çast për të kuptuar
10 çfarë ka ky paragraf.

11 Z. Kehoe, ju pyeti konkretisht për fjalinë e dytë të
12 këtij paragrafi, Në këtë fjali thuhet që:

13 "Në këtë fazë, Thaçi shpjegoi që UÇK-ja është një ushtri
14 e re dhe që po formalizon strukturat e veta".

15 A ju kujtohet a e ka thënë këtë gjë z. Thaçi?

16 PË. Po.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në fjalinë tjetër thuhet
18 si më poshtë:

19 "Ai", domethënë z. Thaçi, "dhe Limaj thanë se UÇK-ja
20 kishte një gjykatë ushtarake, një polici ushtarake dhe një
21 polici sekrete megjithëse nuk dhanë hollësi lidhur me këto
22 organe".

23 Sërish pyetja që kam për juve është kjo a përputhet kjo
24 me atë çfarë ju kujtohet të ketë treguar z. Thaçi dhe z. Limaj
25 se cilat ishin strukturat që ekzistonin në atë kohë, pra, në

1 1998?

2 PË. Po, përputhet.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Gjatë këtij takimi, siç e
4 kuptoj unë, ju dhe z. Buockaert, keni shprehur shqetësim sa i
5 takon trajtimit të ndaluarve të të arrestuarve nga UÇK-ja dhe
6 nivelit të përputhshmërisë së UÇK-së me detyrimet
7 ndërkombëtare. Është e saktë kjo?

8 PË. Po, e saktë është.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të na tregoni sesi
10 reagan z. Limaj dhe z. Thaçi me aq sa ju kujtohet, sa i takon
11 këtyre shqetësimeve të ngritura prej jush ose kritikave që
12 kishit ndaj UÇK-së?

13 PË. Reagimi përmbante dy pika kryesore. E para ishte
14 angazhimi i deklaruar për të respektuar detyrimet e tyre dhe
15 pranimi i detyrimeve që ata kishin dhe së dyti janë këto
16 pretendimet që i diskutuam dhe më herët, domethënë, që ushtria
17 ishte duke u formuar, ishte në rrugën e formimit dhe që kishin
18 këto institucionet tashmë, pra, kishin gjykatën ushtarake,
19 policinë ushtarake dhe policinë sekrete. Megjithatë, sa i
20 takon policisë ushtarake, unë kam pasur vetë përvojë të dorës
21 së parë. Unë jam takuar me individë që thonin që i përkisnin
22 policisë ushtarake, kështu që e marrë për të vërtetë këtë gjë.

23 Domethënë, me pak fjalë ky ishte qëndrimi i tyre karshi
24 këtyre kritikave tona.

25 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të vazhdojmë në

1 faqen 10 dhe të shohim një tjetër pjesë të deklaratës së z.
2 Bouckaert. Do i kërkoja Sekretares që të na tregojë
3 paragrafin 55.

4 Përsëri hidhi një sy, z. Dëshmitar, lexoni përmbajtjen e
5 këtij paragrafi.

6 PË. E keni fjalën për paragrafin 55, apo jo?

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Po.

8 PË. E lexova.

9 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A e kujtoni në qoftë se
10 gjatë bisedës që keni pasur me z. Limaj dhe z. Thaçi, nëse ju
11 vetë apo z. Bouckaert ka përmendur drejtpërdrejt deklaratën
12 publike të z. Krasniqi angazhimit të UÇK-së për të respektuar
13 Konventën e Gjenevës? A ju kujtohet kjo?

14 PË. Nuk besoj se e kemi përmendur deklaratën e z. Krasniqi.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Nuk kam
16 pyetje të tjera për ju.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
18 çaktivizuar].

19 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit, Gjykatësi
20 Smith.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Radha e Gjykatësit
22 Gaynor.

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Znj. Sekretare, do ju
24 kërkoja që të na paraqiste shënimin përgatitor të dëshmitarit
25 në paragrafin 26.

1 Dëshmitar, dëshiroj që t'ju bëj disa pyetje të tjera të
2 cilat kanë të bëjnë me takimin me z. Thaçi dhe Limaj më 10
3 nëntor 1998.

4 Duke i lënë mënjanë diskutimet për dy gazetarët e
5 Tanjugut, ju përveç gazetarëve keni diskutuar dhe raste të
6 tjera të shkeljeve të ligjeve të luftës nga UÇK-ja.

7 Në shënimin përgatitor me ZPS-në në paragrafin 26
8 dëshiroj që të shikoni pjesën përkatëse. Ju thoni që ju dhe:

9 "Z. Bouckaert keni ngritur dhe shqetësime të tjera të
10 pretendimeve për shkelje të ligjeve të luftës nga UÇK-ja, nuk
11 ishte diskutim abstrakt, ne e bëmë të qartë që bëhej fjalë për
12 pretendime konkrete".

13 Ju thoni që:

14 "Besoni që keni diskutuar dhe kidnapime, keqtrajtimet,
15 dëbimet për të cilat kishit marrë raportime që ishin kryer nga
16 UÇK-ja"

17 Në shënim thuhet më tej që mund të keni diskutuar,
18 gjithashtu edhe pretendime ose raste të cilat mund të kenë
19 qenë pjesë e raportit të tetorit, për shembull, në Rahovec, në
20 Bellacerka, e të tjerë.

21 Tani, sa i takon raportit të tetorit e keni fjalën për
22 raportin e 1 tetorit, apo jo, që e kishte titullin "Shkelje të
23 Së Drejtës Humanitare në Kosovë"?

24 PË. Po.

25 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A i dhatë një kopje të këtij

1 raporti z. Thaçi dhe z. Limaj?

2 PË. Jo, me sa më kujtohet.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po pse nuk ja dhatë?

4 PË. Nuk e di sepse, por duke menduar tani mendoj që mbase
5 mund të mos ketë qenë ndonjë ide e mirë për të dhënë një kopje
6 të këtij raporti. Në atë kohë ne nuk e dinim se kë po takonim.
7 Nuk dinim se çka të prisnim nga takimi, kështu që nuk morëm me
8 vete asnjë material, me aq sa më kujtohet mua sot.

9 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në këtë raport të datës 1
10 tetor të 1998, deklarohet dhe këtu citoj:

11 "UÇK-ja ka kryer shkelje të rënda të së drejtës
12 humanitare ndërkombëtare përfshirë këtu edhe ekzekutime jo
13 gjyqësore si dhe dëbimin e etnikëve shqiptarë dhe të romëve.
14 Janë pothuajse 138 serbë etnikë, disa shqiptarë dhe romë të
15 cilët janë zhdukur në rrethana të cilët përfshijnë UÇK-në. Ka
16 të paktën 39 raste të tilla të cilat janë parë nën ruajtjen e
17 UÇK-së".

18 Ju keni qenë autori kryesor i këtij raporti, apo jo?

19 PË. Po.

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, ju kishit informacione
21 të hollësishëm të paktën për 138 personat e zhdukur në veçanti
22 dhe 39 personat që ishin parë herën e fundit të parë nën
23 ruajtjen e UÇK-së?

24 PË. Po.

25 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A diskutuat ju në takimin që

1 patët me Thaçin dhe me Limajn për këto 138 persona të zhdukur?

2 PË. Jo. Nuk kemi diskutuar për këtë.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Tani, a mund t'ju pyes nga
4 perspektiva e një organizate të të drejtave të njeriut ju
5 takoheni me anëtarë të lartë të UÇK-së. A nuk ishte ky momenti
6 i arit i përshtatshëm që të diskutonit gjëra të kësaj natyre
7 me këta përfaqësues të UÇK-së?

8 PË. Është pyetje e mirë. Por qëllimi i këtij takimi ishte që
9 të vinim një kontakt të parë me këtë ushtri, me grup të
10 armatosur. Përsëri dua të them që ne nuk e dinim se kë po
11 takonim. Qasja që kishim ne aso kohe ishte që të hapnim një
12 linjë komunikimi për çështje të të drejtave të njeriut që të
13 vazhdonim që të bisedonim, të merrnim dhe të jepnim me palën
14 tjetër dhe të krijonim një marrëdhënie ku ne të vazhdonim që
15 të ndanim me ta shqetësimet tona dhe të merrnim informacion që
16 ishte me rëndësi për punën tonë.

17 Mendoj se pjesë e arsyeve të mënyrës sesi e kemi trajtuar
18 bisedimin ishte që ne këtë e kemi parë si takim të parë duke
19 pasur parasysh procesin afatgjatë. Megjithatë unë po ju them
20 sesi e kam menduar situatën atëherë në 1999. Megjithatë kanë
21 kaluar 25 vite dhe në qoftë se e mendoj sot sesi duhet të
22 ishin bërë gjërat, kjo është tjetër gjë.

23 Së pari, në qoftë se do ta dija që ky do ishte takimi i
24 parë dhe i vetëm nuk do i takonim më deri pas përfundimit të
25 konfliktit megjithëse konflikti do të vazhdonte deri në

1 nëntor, pra, po të dija që kjo ishte hera e vetme që do të
2 takohesha me këta zotërinj, sigurisht që duhet që do isha
3 futur në më tepër hollësi do e kisha pyetur edhe për gjëra
4 tjera dhe do i kisha ngritë edhe shqetësime të tjera.

5 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pjesërisht ju përgjigjët
6 pyetjes time, megjithatë dua që t'ju pyes lidhur me hollësitë
7 e vrasjeve të dyshuara nga UÇK-ja për ata që perceptoheshin si
8 bashkëpunëtorë ose kolaboracionistë shqiptarë.

9 Në kohën e hulumtimeve tuaja, a kishit ju informacion të
10 hollësishëm sa i takon këtyre lloj vrasjeve?

11 PË. Në atë kohë, deri në nëntor, ne duhet të kemi botuar
12 informacion, duhet të ketë qenë në raportin e nëntorit, besoj.

13 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A ju kujtohet në atë fazë në
14 qoftë se e kishin ngritur çështjen e vrasjeve të dyshuara nga
15 UÇK-ja, domethënë, vrasjet që dyshoheshin që ishin bërë nga
16 UÇK-ja, jo kundër serbeve por kundër kolaboracionistëve të
17 dyshuar shqiptarë, në qoftë se e keni diskutuar këtë në
18 takimin dhe me Thaçin dhe Limajn?

19 PË. Më kujtohet biseda në vija të gjera, nuk më kujtohet
20 konkretisht në qoftë se kemi diskutuar për kolaboracionistët
21 apo jo. Mund të ketë qenë e mundur, mbase e kemi diskutuar po
22 nuk e them dot me siguri në qoftë se e kemi trajtuar këtë
23 çështje, apo jo?

24 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit shumë. Nuk kam
25 pyetje të tjera.

1 Z. Smith, fjala për ju.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka pyetje të
3 tjera plotësuese?

4 Prokuroria?

5 Z. TIEGER: [Përkthim] Jo, nuk kemi.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Laws,
7 keni?

8 Z. LAWS: [Përkthim] Jo.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Kehoe?

10 Z. KEHOE: [Përkthim] Po kam disa pyetje. Kjo është e
11 para. E dyta, ka disa çështje të cilat dolën nga pyetjet e
12 Gjykatësve të cilat nuk kanë të bëjnë me dokumente të cilat
13 janë ngarkuar në sistem. Kjo është hera e parë që jemi në një
14 situatë të tillë. Në qoftë se pyetjet kanë të bëjnë me
15 dokumente që nuk janë të ngarkuara në sistem më duhet pak
16 kohë. Kështu që do më duhet që të mendoj pak.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Thuajse ka
18 vajtur ora 1.00 kështu që jam i sigurt që do të vazhdojë
19 marrja në pyetje e dëshmitarit të javës tjetër.

20 Z. EMMERSON: [Përkthim] Edhe unë do thoja të njëjtën gjë.
21 Do më duhet të paktën një orë dhe mua që të bëj pyetje të
22 tjera.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull
24 atëherë, gjykata do të përdoret nga një trup tjetër gjykses
25 kështu që do ta mbyllim sot këtu, pa diskutim që të hënën do

1 përfundoni, kjo është e sigurtë po tani ju kërkojmë që të
2 largoheni nga salla e gjyqit.

3 Znj. Sekretare, shoqërojeni dëshmitarin. Ju lutem ju
4 kujtojmë që të mos e diskutoni askënd jashtë sallës së gjyqit
5 çështjet të cilat i diskutuam bashkë sot. Faleminderit për
6 mbështetjen.

7 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit. Ditën e mirë.

8 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
10 çaktivizuar].

11 Z. KEHOE: [Përkthim] Nuk ju kuptova, gjykatës.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] [Mikrofoni
13 çaktivizuar].

14 Z. KEHOE: [Përkthim] Për dy dokumentet në listën e
15 prezantimit e kishit fjalën?

16 I kam në ekran tani i kam. Do t'i kalojmë këto dokumente
17 po nuk i kam këtu.

18 PËRKTHYESJA: Ju kërkoj ndjesë po gjykatësi e ka të fikur
19 mikrofonin.

20 Z. KEHOE: [Përkthim] Më duhet që të konsultohem me
21 kolegët.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] thjesht dua
23 që të sigurohem që i keni këto dokumentet që doni.

24 [Mbrojtja këshillohet]

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull

1 atëherë. Do shihemi përsëri të hënën.

2 Z. KEHOE: [Përkthim] Kam diçka për të thënë nëse më
3 lejoni.

4 Do më duhet që t'i shoh, t'i rishikoj këto dokumente dhe
5 duhet që të kërkoj leje që të ngarkoj dokumente të tjera në
6 qoftë se do më duhet. Nuk e di në qoftë se do kem dokumente të
7 tjera për të ngarkuar në listën e dokumenteve apo jo, po
8 thjesht doja që të kisha lejen tuaj.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kemi qenë
10 shumë liberalë lidhur me këtë çështje, nuk ju premtoj dot gjë
11 se varet se çfarë dokumentesh janë, por megjithatë për
12 momentin e mbyllim këtu do të takohemi përsëri të hënën në
13 mëngjes.

14 Z. EMMERSON: [Përkthim] Më lejoni të bëj një konstatim
15 nëse është e mundur. Tani në listën e dokumenteve të ekipit të
16 Mbrojtjes tonë përfshihet edhe vendimi në çështjen kundër
17 Milutinovic, të cilën e trajtova dhe në fillim fare të marrjes
18 së dëshmisë prej këtij dëshmitari.

19 Mbase e kam çorientuar në mënyrë të paqëllimshme Gjykatën
20 duke thënë që ishte pjesë e vendimit përfundimtar të Gjykatës,
21 në fakt, ishte një vendim pranueshmërie që kishte të bënte me
22 raportin "Nën Urdhra", por dua që t'ua sillja këtë në
23 vëmendje. Mendoj që ky është një dokument i rëndësishëm sepse
24 në një moment të përshtatshëm, jo gjatë marrjes në pyetje, por
25 në një moment të përshtatshëm do t'i kërkojë Trupit Gjykses që

1 të rishqyrtojë vendimin e vetë për këtë dokument në kapitullin
2 10. Pra, ne parashtrojmë, do parashtrojmë që pasi kemi dëgjuar
3 dëshminë raporti "Nën Urdhra", në fakt, nuk është cilësuar
4 ashtu siç duhet nga Trupi Gjykues.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

6 Duhet ta bëni këtë parashtrim me shkrim.

7 --- Seanca mbyllet në orën 12.49

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25